



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 06.07.2015, ora 16:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i kalendarit të punimeve të komisionit 03 – 23 Korrik 2015.

2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjeve ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet kontraktues dhe shoqërive “S2 ALBANIA”,sh.p.k, dhe “RAPISCAN SYSTEMS”.INC, “Për zgjidhjen me mirëkuptim të mosmarrëveshjeve” dhe “Për ndryshimin e marrëveshjes së koncesionit, për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontenierëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 123/2013”, si dhe të tarifës së shërbimit të skanimit””.

3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programin e Bashkimit Europian për punësimin dhe inovacionin social (EASI)”

4. Projektligji “Për turizmin”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Vasilika Hysi, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Petrit Vasili, Silva Caka, Eduart Halimi, Arben Ristani, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Pirro Lutaj, Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Dashamir Peza, Anila Agalliu, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Shkëlqim Cani – ministër i Financave.

Irena Beqiraj - zëvendësministre i e Financave.

Bardhyl Sejdarasi – specialist në Ministrinë e Financave.

Bardhylka Kospiri - zëvendësministre i e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Kledia Mazniku - drejtoreshë e Shërbimeve Juridike në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Ervin Mete – zëvendësministër i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Ardit Çollaku - këshilltar në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Sonia Popa - drejtoreshë e Përgjithshme e Turizmit.

Alma Baze -drejtore e Standardizimeve për Turizmin.

Enton Diamanti - përgjegjës sektori në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e komisionit. Pika e parë e rendit të ditës është miratimi i kalendarit të punimeve të komisionit. Është thjesht një reflektim i asaj çfarë është vendosur në Konferencën e Kryetarëve dhe në seancë plenare.

Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programin e BE-së për punësimin dhe inovacionin social.”

Nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe e Rinisë, që është edhe ministria iniciuese dhe përgjegjëse, është zonja Bardhylka Kospiri, zëvendësministre dhe zonja Kledia Mazniku, drejtoreshë e shërbimeve juridike.

Zonja Bardhylka, do t’ju lutesha të bënit një paraqitje të përmbledhur shkurtimisht për deputetët, pavarësisht se e kanë projektin me gjithë relacionin.

Zonja Kospiri, urdhëroni!

Bardhylka Kospiri – I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Me miratimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programin e BE-së për punësimin dhe inovacionin social”, bëhet e mundur pjesëmarrja e Shqipërisë në këtë program, duke përfutur mbështetje financiare në nivel kombëtar në fushat e punësimit, në çështje sociale, për të zhvilluar sistemin aktual të mbrojtjes sociale dhe politikave të tregut të punës, duke promovuar qeverisjen e mirë, të mësuarit reciprok dhe inovacionin social.

Shqipëria si vend kandidat mund të përfitojë në dy nga tre akset e programit. Njëri aks është aksi progres, që do të mbështesë përmirësimin e politikave në tre seksione tematike punësim dhe në veçanti, për të luftuar papunësinë tek të rinjtë, mbrojtjen sociale, përfshirjen sociale, ulje të varfërisë, si dhe kushtet e punës të përcaktuara në 4 objektiva, që lidhen me përhapjen në cilësi të lartë të njohurive analitike, krahasuese, lehtësim efektiv dhe gjithëpërfshirës në shkëmbimin e informacionit, sigurimi i mbështetjes financiare për të promovuar rritjen e politikave sociale dhe ato të tregut të punës, si dhe sigurimi i organizatave me

mbështetje financiare për të rritur kapacitetin e tyre, për të zhvilluar promovim në mbështetje të zbatimit të instrumenteve dhe politikave të BE-së.

Aksi 2 është ai mikrofinanciar dhe ndërmarrjes sociale. Mbështet veprimet në dy seksione tematike: mikrokredi për grupet e cënueshme, si dhe mikrondërmarrje dhe sipërmarrje sociale në tri objektiva.

Objektivi i parë është rritja e aksesit dhe disponueshmërisë së mikrofinancës për grupet e cënueshme, të cilat dëshirojnë për të ngritur ose për të zhvilluar biznesin e tyre dhe të mikrondërmarrjeve.

Objektivi i dytë është ndërtimi i kapaciteteve institucionale të ofruesve të mikrokredive.

Objekti i tretë është mbështetja e zhvillimit të ndërmarrjes sociale, në veçanti duke lehtësuar qasjen në financa.

Në lidhje me planifikimin e efekteve financiare, që rrjedhin nga zbatimi i kësaj projekt marrëveshjeje sqarojmë se vlera prej 50 mijë euro është planifikuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe e Rinisë dhe është akorduar në buxhetin e vitit 2015 si kosto lokale në programin buxhetor planifikim, menaxhim dhe administrim.

Shqipëria për të marrë pjesë në këtë program duhet të paguajë në buxhetin e përgjithshëm të BE-së një kontribut financiar, për vitet 2014-2016 20 mijë euro dhe për vitet 2017-2020 100 mijë euro. Kontributi i Shqipërisë do të mbulojë kostot, që lidhen me përgatitjen fizibilitetin, zhvillimin dhe zbatimin e projekteve me interes të përbashkët, si dhe për zhvillimin dhe zbatimin e masave horizontale, siç janë parashikuar në program.

Ky kontribut do të mbulohet nga buxheti i Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Në vitet në vijim, pas miratimit të instrumentit financiar IPA 2 nga Komisioni Europian, Shqipëria do të ketë mundësi rimbursimi deri në 80% të kontributit të saj financiar.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Kospiri për ekspozenë tuaj!

Relatorja, urdhëroni!

Silva Caka – Faleminderit, zoti kryetar!

Zonja zëvendësministre ishte shumë e qartë në ekspozenë e saj. Në aspektin ligjor dhe procedural projektligji është i rregullt edhe në aspektin e teknikës legjislativ. Nuk kam asgjë për të shtuar. Kështu që i ftoj kolegët për ta miratuar atë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka pyetje? Nuk ka. Diskutime? Nuk ka.

Kush është dakord me projektligjin, në parim? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Kush është dakord me nenin 1? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me projektligjin në tërësi? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Faleminderit për praninë tuaj!

Pasdite të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 06.07.2015, ora 16:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjeve,ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet kontraktues,dhe shoqërive “S2 ALBANIA”,sh.p.k., dhe “RAPISCAN SYSTEMS”.INC, “Për zgjidhjen me mirëkuptim të mosmarrëveshjeve” dhe “Për ndryshimin e marrëveshjes së koncesionit, për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontenierëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me ligjin nr. 123/2013, si dhe të tarifës së shërbimit të skanimit”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Vasilika Hysi, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Petrit Vasili, Silva Caka, Eduart Halimi, Arben Ristani, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Pirro Lutaj, Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Dashamir Peza, Anila Agalliu, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Shkëlqim Cani – ministër në Ministrinë e Financave.

Irena Beqiraj - zëvendësministre në Ministrinë e Financave.

Bardhyl Sejdarasi – specialist në Ministrinë e Financave.

Fatmir Xhafaj - Vazhdojmë me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjeve ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet kontraktues, dhe shoqërive “S2 ALBANIA”, sh.p.k., dhe “RAPISCAN SYSTEMS”.INC, “Për zgjidhjen me mirëkuptim të mosmarrëveshjeve” dhe “Për ndryshimin e marrëveshjes së koncesionit, për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontenierëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me ligjin nr. 123/2013, si dhe të tarifës së shërbimit të skanimit”.

Projektligji është paraqitur nga qeveria. Iniciues i projektit është Ministria e Financave.

Të pranishëm për të paraqitur projektin dhe për t’u dhënë përgjigje komenteve apo pyetjeve deputetëve është vetë ministri i Financave, zoti Shkëlqim Cani, së bashku me zëvendësministren e Financave.

Zoti Cani, urdhëroni!

Shkëlqim Cani – Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Qeveria shqiptare arriti të zgjidhë me mirëkuptim marrëveshjet, lidhur me kontratën koncensionare me shoqërinë RAPISCAN dhe S2 Albania sh.p.k.

Kjo kontratë ka qenë e miratuar me ligjin nr. 123/2013 dhe ka pasur për objekt financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontenierëve dhe automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë, si dhe tarifën e shërbimit të skanimit. Ky ligj është miratuar në 24 prill 2013 dhe brenda një jave më 2 maj dhe është firmosur ose është dekretuar nga Presidenti.

Deri në muajin shtator 2013 ky shërbim nuk ishte materializuar, por punimet kishin filluar në dy pika kontrolli. Kundërshtimi dhe rezistenca e biznesit, lidhur me këtë kontratë ishin të mëdha, të konsiderueshme dhe kryesisht përqendroheshin në fund të gjitha ankesat për nivelin e lartë të tarifës së shërbimit. Po kështu, edhe Autoriteti i Konkurrencës rekomandoi rishikimin e kontratës koncensionare.

Qeveria synoi të bëjë nulë këtë kontratë koncensionare dhe tentoi ta anulojë kontratën, por nuk mundi. Ishte e pamundur. Kështu që si Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, si Ministria e Financave, por edhe qeveria u detyruan të zgjedhin bashkëbisedimin për këtë shërbim, për këtë kontratë.

Në periudhën maj-shtator 2014 me shoqërinë përkatëse ne kemi zhvilluar negociatat e para si Ministri e Financave. Kështu që negociatat ishin të domosdoshme për arsye, siç thashë edhe në fillim, kjo kontratë ishte e lidhur, kishte marrë bekimin e qeverisë së mëparshme dhe të parlamentit të mëparshëm.

Rezultatet nga negociatat e para janë që pavarësisht nga dëshira e mirë e autoritetit kontraktues, pra e Ministrisë së Financave, bashkë me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, nuk u arrit ndonjë rezultat pozitiv. RAPISCAN nuk pranoi si option të mundshëm negocimin dhe për pasojë e çuan çështjen në arbitrazh dhe kërkonin zhdëmtimin në arbitrazhin e Parisit për prishjen e koncesionit të skanimit të kontenierëve me një shumë prej 360 milionë dollarë.

Kështu që çështja i kaloi Avokaturës së Shtetit dhe në mbështetje të këtij institucioni u zgjodh firma avokatore ndërkombëtare “Omnia Strategy”. Duke u gjendur përpara këtij fakti, ne përsëri tentuam zgjidhjen me mirëkuptim. Pra, të dyja palët tentuan edhe një herë tjetër zgjidhjen me mirëkuptim të kësaj çështjeje. Kështu që me urdhër të Kryeministrit, datë 01.02.2015 u ngrit grupi negociator ndërinstitucional i punës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me RAPISCAN dhe S2 Albania.

Grupi drejtohej nga ministri i Financave dhe objektiv kishte gjetjen e zgjidhjes jashtë arbitrazhit. Ky rekomandim i urdhrat të Kryeministrit në fakt mbështetej edhe nga Omnia.

Cilat janë rezultatet nga negocimi i dytë i grupit të punës? Grupi i punës paraqiti shumë pika për negocim me RAPISCAN-in, por pas bisedimeve do t'i quaja relativisht të gjata, ose debate të zhvilluara midis palëve ku u arrit të negocioheshin vetëm disa pika, që ishin më të ndjeshme dhe më të kundërshtuara në opinionin publik dhe që kishin të bënin kryesisht me vlerën e kontratës dhe me saktësimin e jetëgjatësisë së kontratës.

Ndryshime të tjera kishin të bënin me hyrjen në fuqi të ndryshimeve dhe jashtë këtyre pikave RAPISCAN nuk pranoi diskutime të tjera, lidhur me atë pjesë të kontratës që është debatuar, diskutuar, negociuar dhe dakordësuar me RAPISCAN.

Për çmimin e kontratës, që është çështja kryesore, u negociua mënyra e përlllogaritjes së vlerës, që do të përfitonte RAPISCAN. U kërkua që çmimi i kontratës të mos përcaktohej nga numri i deklaratave doganore shumëzuar me tarifën për kontratë për deklarata doganore, pra, të hiqej dorë nga çmimi për deklarata doganore prej 39 euro për deklarata.

U zgjodh një mënyrë tjetër, dhe me palën amerikane u ra dakord të kalohej në një çmim fiks. Pra, nga sistemi numër kontratash shumëzuar për 39 euro për kontratë dhe që ishte kontratë e hapur dhe që çdo vit numri i kontratave rritej në varësi të ecurisë së eksport- importit, në nivel tjetër, pala amerikane në krye të 15 vjetëve do të merrte një shumë të caktuar dhe u fiksua që në vitin e parë të plotë të punës të të pesë pikave të skanimit, pala amerikane do të merrte në vitin e parë 11,3 milionë dollarë në vit dhe në vitet vijuese, duke filluar nga i dyti e me radhë do të merrte një rritje të vlerës prej 3%. Në këtë mënyrë kufizohej pagesa nga pala shqiptare në 210 milionë euro në total në krye të 15 vjetëve, ose duke zbritur tarifën e koncesionit, pala amerikane nga kjo kontratë merr 206 milionë euro.

Nëse duam të bëjmë një llogaritje, pra, dimë sa merr me kontratën e re, dhe se sa do të merrte me kontratën ekzistuese ose me ligjin ekzistues, mund të them që në fillim se niveli mund të jetë edhe më i lartë, por kursimi nga ndryshimi që bën në kontratën e re është nga 100 deri në 180 milionë euro.

Pra, kursimi nga negociatat nuk mund të shkojë poshtë 100 milionë eurove, kurse ne kemi zgjedhur një marzh, se kuptohet, është në varësi të nivelit të rritjes së deklaratave nga viti në vit, por në vlera konservative, kursimi është nga 100 milionë deri në 180 milionë, por kursimi mund të jetë edhe më i lartë nëse tempi i rritjes së deklaratave doganore do të jetë më i lartë.

Pse themi që do të jetë më i lartë dhe çfarë na bën që të jetë më i lartë ose jo? Llogaritjet tona janë llogaritje konservative. Ne kemi supozuar për këtë nivel kursimi sikur numri i deklaratave doganore, që do të rriteshin nga viti në vit, të jetë vetëm 5%.

Në fakt, në qoftë se shkojmë pas në vite dhe marrim një mesatare të rritjes së nivelit të deklaratave doganore nga viti në vit, në 10 vjetët e fundit, që kanë brenda edhe 6 vjetët e krizës, rritja është nga 5% në vit deri në 13% në vit. Pra, në qoftë se duam të bëjmë një mesatare, duke përfshirë brenda edhe vitin e krizës, që natyrshëm në vitet e krizës bie niveli i tregtisë, i eksport-importit, i rritjes ekonomike etj., dhe dihet se në çfarë gjendje është ekonomia shqiptare në këto vite. Pra, në qoftë se duam të marrim edhe këto 10 vjet, që e kanë brenda krizën, rritja e

numrit të deklaratave nga viti në vit ka qenë nga 5% deri në 13%, që mesatarisht besoj se në 15 vjetët e ardhshme duhet të jetë diku në nivelin nga 8% deri në 15%, por kjo i përket të ardhmes. Duke i bërë këto llogaritje me një qëndrim konservator për këtë çështje nuk mund të bie kursimi nga ky negociim poshtë 100 apo 180 milionë euro kursim nga kontrata ekzistuese.

Kuptohet që çdo ecuri përtej këtij kufiri të numrit të kontratave do ta shtonte nivelin e kursimit ose masën e kursimit nga pagesa, që do t'i bëjmë palës amerikane. Ndërkohë, duhet të marrim parasysh edhe kur do të fillojë zbatimin kjo kontratë dhe duhet të nisemi nga ç'nivel numri i kontratave do të fillojë ky ligj.

Ne kemi supozuar që të fillojë me 365 mijë deklarata, gjë që në fund të vitit 2014 është mbi këtë vlerë, kështu që doemos edhe niveli i kursimit është edhe më i madh, por këto janë llogaritje dhe ne do të përpiqemi ose të paktën këtu përpara jush duam të japim atë që është më konservatorja dhe më e sigurt në kursim. Kuptohet, kursimi mund të shkojë edhe përtej këtyre kufijve, mund të shkojë edhe në 300 milionë euro.

Lidhur me jetëgjatësinë e kontratës, në fakt, në kontratën ekzistuese ishte i paqartë afati i jetëgjatësisë së kontratës, për arsye se lidhej me instalimin e skanerit të pestë, i cili nuk ishte limituar në kohë.

Pra, firma mund ta vinte në punë skanerin e pestë në një kohë kur të vendoste ajo për pasojë ishte shumë e dyshimtë se kur mbyllej kontrata, kur ishte fundi i kontratës. Meqenëse ishte kështu, pra, vërtet ishte thënë 15 vjet, nuk ishte fiksuar qartë se kur vendosej në punë skaneri i pestë, ne u detyruam që ta rinegociojmë kontratën edhe në këtë pikë dhe ramë dakord dhe është në ligjin e ri ose në kontratën e re që pala amerikane, do ta përmbushë detyrimin e vet për të pestë skanerët që vitin e parë. Pra, maksimumi që mund të zgjasë periudha për vënien në punë të pestë skanerëve nuk do të jetë më shumë se një vit. Për pasojë edhe kontrata nuk mund të jetë si kohëzgjatje më shumë se 16 vjet. Ndërkohë, palës amerikane nuk i paguhet asnjë ditë më shumë se 15 vjet punë të çdo skaneri. Pra, kontrata në tërësinë e vetë mund të zgjasë 16 vjet, por skaneri i parë që fillon punën, supozojmë më 1 gusht, do të përfundojë më 1 gusht pas 15 vjetësh. Nëse i pesti do të zgjasë për t'u vënë në punë deri më 1 gusht 2016, do të kemi një vit më pas të punës së skanerit të pestë, por do të paguhet vetëm për 15 vjet. Nuk do të paguhet përtej 15 vjetëve. Kështu që kjo mënyrë të rinegociatës të të gjithë kontratës ka bërë që shuma prej 210 milionë euro të jetë e patejkalueshme dhe siç thashë në qoftë se do të zbresim neto edhe

fee-n koncensionare, zbret diçka kjo shumë, por shoqëria amerikane merr jo më shumë se 210 milionë euro.

Po kështu, u konkludua që në pagesën për arbitrazhin të mos mbahen kostot e arbitrazhit nga pala shqiptare, por t'i paguajë pala amerikane dhe u ra dakord që deri në çastin që kontrata hyn në fuqi dhe që ne po e kalojmë në procesin e miratimit në Kuvend, palët nuk kanë detyrime ndaj njëra-tjetrës, ose nuk vijojnë procesin e arbitrazhit që edhe kjo doemos ishte një çështje e rëndësishme për ne.

Siç e thashë edhe në fillim ne tentuam të negociojmë edhe me elemente të tjera të kontratës, por nuk u pranua nga pala e RAPISCAN-it.

Lidhur me skemën e pagesës nga biznesi, siç ju thashë, kontrata bazë kishte numër kontratash ose deklaratah doganore shumëzuar për 39 euro. Në fakt, ne në qoftë se do t'i bëjmë llogaritjet dhe ndoshta nuk do t'ju lodh me llogaritjet, por unë i kam të bëra dhe i kemi të detajuara në tabelë, dhe kush është i interesuar mund t'ia kaloj tabelën, e rëndësishme është që në fund të kësaj historie biznesi duhet të paguajë për çdo deklaratë doganore jo 39 euro, por vetëm 22 euro. Pra, kursehen 43,6 ose niveli i tarifës për çdo deklaratë doganore nuk është më 39, por 22, ose 43,6% më e ulët nga ajo që ishte parashikuar në ligjin aktual. Kurse deklaratat që kanë një vlerë nën 1 mijë euro do të paguajnë një kosto vetëm prej 5 euro. Për vitet e para ka një pjesë të pambuluar të kostos. Pra, atë që do t'i paguajmë çdo muaj palës amerikane dhe asaj që do të mbliidhen nga tarifat për çdo deklaratë doganore, kosto, e cila në vitet e para deri në arrijtjen e pikës kritike, do të mbulohen nga buxheti i shtetit. Pra, në këtë rast buxheti merr përsipër mbulimin e një pjese të kostos së kësaj kontrate të re që është negociuar me palën amerikane.

Këto ishin çfarë doja të pasqyroja. Deri tani kam folur për elemente tregtare, por nuk kam pse të mos përmend që kjo kontratë zgjidhte dhe zgjidh, më duhet ta ritheksoj, se nuk bëhet ndonjë ndryshim, edhe çështje të tjera që lidhen me parandalimin e kontrabandës, me sigurinë kombëtare, me sigurimin e kufijve, me kontrabandën, kryesisht të produkteve të akcizës, të lëndëve narkotike, të produkteve të dëmshme, të armëve, të municioneve etj. Pra, kontrata veç elementit tregtar, ka edhe këto elemente shtesë, për të cilat ka qenë e domosdoshme për t'u vijuar me të.

Këto ishin çfarë doja të parashtroja përpara deputetëve për rinegocimin e një kontrate të miratuar nga qeveria e kaluar dhe nga Kuvendi i kaluar.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Ministër!

Ka ndonjë gjë për të shtuar relatori?

Ulsi Manja – Ne jemi një komision për dhënie mendimi. Projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe ka respektuar kërkesat e Rregullores së Kuvendit.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Ka pyetje? Zoti Bylykbashi, urdhëroni!

Oerd Bylykbashi - Zoti Ministër, ju bëtë një ekspozitë të gjatë, duke detajuar se cilat ishin përfitimet e mundshme, që vijnë nga ky rinegocim i zgjidhjes së kësaj mosmarrëveshjeje, keni tabela. Madje, në fund thotë se me këtë kontratë garantohej edhe siguria kufitare, për shkak se eliminojmë kontrabandën e aktivitete të tjera të paligjshme, që mund të ndodhin nëse nuk do të ishte ky shërbim.

Doja të dija, kur ju vendosët si qeveri ta prishnit këtë kontratë, ta bënit nulë, përkundër edhe kundërshtive të opozitës, a bëtë ndonjë vlerësim të rrezikut që po i vinim ndesh ne? Ju e theksuat vetë, rrezikonit që në arbitrazh nëse do të fitonte kompania amerikane, taksapaguesit shqiptar, për shkak të vendimit tuaj, do të paguanin 360 milionë dollarë amerikanë. A bëtë një vlerësim të kësaj gjëje? A ishit të ndërgjegjshëm për këtë rrezik?

Së dyti, ju zoti Ministër, pra, qeveria (ju përfaqësoni qeverinë këtu), dhe për fat të keq parlamenti ju mbështet në çdo veprim që bëni, pse nuk patë opsionin e negocimit të këtyre elementeve që thoni? Pra, në fund fare keni kërkuar, e thoni edhe në relacion, shumë çështje, por vetëm dy çështje ju pranoi pala amerikane, sepse e kishte mundësi ta bënte këtë. Për t'ju shpëtuar fytyrën ju, ka ulur çmimin, dhe ka caktuar afatin, pastaj të gjitha ato tabelat dhe detajimet pak vlerë kanë.

Pra, pse nuk patë mundësinë e negocimit që na paska qenë problem kjo? Sepse bie ndesh. Ose doni ta prishni, ose doni kushte më të mira dhe të vazhdoni sigurinë e kufirit.

E treta, nëse ju doni ta prishnit në atë kohë, cila ishte ideja? Do të kishit ndonjë kompani tjetër, që do të sugjerohej nga një kompani konsulente doganash apo ku di unë çfarë do të ishte, apo do të lejohej pas regjimit, siç ka qenë vendosur përpara këtij koncesioni?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Zoti Ministër, urdhëroni!

Shkëlqim Cani – Besoj se nuk prish ndonjë rregull në qoftë se filloj nga fundi dhe të kaloj pastaj në fillim. Rëndësi ka që t'u përgjigjem të tria pyetjeve. Nëse do të prishej si do ta zgjidhnim? Këtu të tria pyetjet kanë supozimin brenda, ndërkohë që këtu vijmë përpara faktit dhe kemi një realitet dhe supozime. Besoj se të dyja palët biem dakord që më i rëndësishëm është realiteti se sa supozimet, por le t'i marrim edhe supozimet.

Ka zgjidhje dhe disa mënyra për ta zgjidhur. E rëndësishme është dhe besoj që doli qartë që si qeveri ne ndiheshim po aq të shqetësuar, sa edhe biznesi për koston e rëndë, që duhet të përballonte biznesi, lidhur me këtë kontratë të lidhur nga një qeveri. Duke u nisur nga ky faktor, doemos edhe ne e kemi parë dhe jemi përqendruar në uljen e kostos, por nuk është vetëm kostoja që zgjidh gjithçka, por të them të drejtën, natyrshëm unë u përqendrova shumë te kosto 1, meqë kjo është fusha e veprimtarisë, por besoj se edhe publiku në fund i duhet shumë kjo çështja e kostos, sepse çështja e të kërcënuarit të ekonomisë varet nga shumë faktorë. Varet edhe nga këto që përmenda, që janë çështje të sigurisë kombëtare, por siguria kombëtare kërcënohet edhe nga pagesat përtej një kufiri të caktuar, ose nga kosto që mban buxheti në 15 vjetët e ardhshme dhe t'i heqësh koston e buxheteve të viteve të ardhshme kontrata të cilat kishin mundësinë e negociatave, praktika tregoi që u arrit të negociohej dhe me rezultat, që besoj se duhet vlerësuar.

A ka një zgjidhje tjetër? Një zgjidhje tjetër është t'i bleh vetë dhe t'i instalosh, siç kemi në Durrës, pavarësisht se ajo herë pas here prishet, por mund t'i blije këto dhe kanë një kosto të caktuar dhe i menaxhon vet. Kështu që kishim disa opsione për ta zgjidhur nëse do të arrinim ta zgjidhnim këtë kontratë dhe t'ia hiqnim këtë barrë, këtë kosto biznesit, kuptohet edhe ekonomisë në tërësi.

Kështu që unë them se që kur filluam negociatat, bisedimet dhe që kur menduam për të gjetur një zgjidhje tjetër, pra, të prishnim këtë për të gjetur alternativa të tjera ose të rihapnim këtë çështje për të parë kompani të tjera, që e sjellin me çmime shumë më të ulëta dhe mund ta menaxhojmë shumë më ulët, ose t'i blinim vetë si shtet dhe ta zgjidhnim këtë çështje.

Kjo ishte e gjitha çështja llogaritjesh, në fund të fundit. Pse nuk pamë elementet e negociimit që në fillim? Nuk është që ka qenë zero çështja e negociimit që në fillim, por të dyja

palët testuan njëra- tjetrën dhe që në fillim ne hasëm në mendimin shumë të qartë të palës amerikane, që kjo kontratë është në fuqi, kjo kontratë ka bekimin e qeverisë shqiptare, ka bekimin e parlamentit. Kështu që ne nuk ndiejmë nevojën e kësaj negociate dhe të qenurit në këtë pozitë, disi ta quajmë, se ne nuk besoj që i trembemi. Të privilegjuar nga ajo palë kuptohet që ne ishim në një pozitë më të disfarvoshme dhe do të na duhej të ishim, po e quaj me një fjalë, jo në kuptimin negativ të vetin, më agresivë në argumentet tona dhe në dëshirën tonë për ta riparë kontratën.

Kur do të bënit nulë kontratën, a bëtë vlerësime të risqeve për kostot për publikun? U përmend shifra e kërkuar më pas nga RAPISCAN për 360 milionë euro.

Kuptohet kur tenton të bësh nulë një kontratë, bën vlerësimet e tua dhe janë një mori treguesish faktorësh, një mori po e quaj kalkulimesh, por edhe juridike dhe ekonomike që ne na çonin në bindje që ne mund ta nulifikojmë kontratën.

Gjatë negociatave, siç ju thashë ka kaluar dy faza negociatash. Ne u hasëm edhe me argumentet e palës tjetër dhe gjatë debateve kuptonim edhe përqendrimet tona se deri ku mund të shkonim. Më pas, siç edhe ju thashë, duke qenë se çështja kaloi në arbitrazh dhe u kërkuar shuma e caktuar, kuptohet edhe ne morëm Avokaturën e Shtetit dhe doemos edhe një mbështetje juridike, një firmë të huaj, pastaj riformatua qëndrimin tonë duke gjetur vetveten.

Natyrshëm, mund të them se nuk e besoj se kemi ndonjë iluzion që në biznes ata gjykuan se ne jemi të mirë apo të këqij dhe donin të na bënin ndonjë favor. Të dyja palët këmbyen argumentet midis tyre, të dyja palët treguan pikat e forta dhe të dobëta, që kishin, dhe në fund u konkludua, siç është edhe rezultati tani, që është më i lehtë për mua, për ta argumentuar që duket se të dyja palët gjetën vetveten. Edhe ata kishin pika të forta dhe të dobëta, edhe ne kishim pikat e forta dhe të dobëta. Jua thashë pika, epiqendra e çdo debati nga pala tjetër ishte që tashmë bëjmë fjalë për një kontratë të firmosur, të miratuar në qeveri dhe që ka marrë bekimin e parlamentit. Kjo ishte një pikë e fortë për ta dhe që doemos na vinte në siklet në këto argumente.

Fatmir Xhafaj – Ka pyetje të tjera? Zoti Halimi, urdhëroni!

Eduard Halimi – Njërin kam për procedurë me ju, por edhe me ministrin për të pasur bashkëngjitur marrëveshjen. Ne nuk e kemi të bashkëngjitur marrëveshjen, ose në qoftë se është

dhe ne nuk e kemi, kërkoj kohë që ta marrim dhe ta shqyrtojmë. E keni sjellë këtë marrëveshje të bashkëngjitur, zoti Ministër, apo jo?

Fatmir Xhafaj – Po, është marrëveshja këtu.

Eduard Halimi – Ka ardhur, është shpërndarë?

Fatmir Xhafaj – Po, është shpërndarë edhe në mënyrë elektronike. Është aty merreni dhe shikojeni.

Eduard Halimi – E dyta, zoti Ministër, se sa do të jetë përfitimi, këtë do ta shikoj, se do të lexoj edhe kontratën, por pyetja ime është sa lekë keni harxhuar ju si institucion brenda këtyre dy vjetëve për të arritur në këtë marrëveshje ? E thënë ndryshe, sa keni paguar për rrugët e arbitrazhit në këta dy vjet për të arritur asgjë?

Shkëlqim Cani – Tani ne kemi vetëm një kosto për të paguar, që është kostoja e firmës së Avokaturës së Shtetit. Nëse jam i saktë, nuk e kujtoj shifrën ekzakte, por mund t’jua sjell pa diskutim, duhet të jetë diku te 500 mijë euro, 500 mijë paund... Besoj se në këto nivele duhet të jetë. Kurse të gjitha kostot e tjera ju thashë, arbitrazhi, pra, të gjitha, i paguan pala amerikane dhe ne nuk paguajmë asgjë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Ristani, urdhëroni!

Arben Ristani – Ju ndoqa me vëmendje dhe ju thatë se kontrata kishte dy probleme, vlera e kontratës dhe jetëgjatësia. Thatë se këto dy çështje janë të rëndësishme, sepse opinioni publik ishte i ndjeshëm ndaj këtyre çështjeve.

A mund të më thoni si e matët ju opinionin publik që ishte i ndjeshëm ndaj këtyre dy çështjeve?

Kam edhe disa pyetje të tjera, por preferoj t’i bëj një nga një.

Shkëlqim Cani – Për të qenë korrekt nuk thashë se kishte dy probleme, por u pranuan dy probleme. Krahas problemeve të tjera se nga vetë parashtresa një herë janë dy probleme kryesore që zgjidhëm, por edhe disa probleme të tjera. Pra, janë zgjidhur disa probleme, por dy ishin kryesoret, kurse për ne nuk ishin dy probleme, për ne ishin një mori problemesh, por deri këtu shkuam me negociatat se negociatat janë negociata. Secila nga palët duhet të lëshojë.

Nuk kam thënë ndjeshmëri të opinionit publik. Janë të biznesit. Më fal!

Dakord. Ne reaguam ndaj biznesit se është 39 euro dhe nuk e paguan opinionin. Opinioni në fund... Po, ne me biznesin punojmë! Ministria e Financave... Nga të gjitha llojet e veprimeve, nga të gjitha llojet e takimeve. Takime të drejtpërdrejta me shoqatat e biznesit, letra të ndryshme...

Fatmir Xhafaj – Ju lutem, zoti Ristani, nëse bëni pyetje, dakord, në të kundërt e mbyllim këtu dhe vazhdon me të tjerat. Dakord. Por, të lutem, mos i ndërhy, të përgjigjet ai. Ti i bën pyetjet si e mendon ti, ai do të të japë përgjigjen si e mendon. E keni thënë ju vetë atë dhe unë jua kam respektuar. Ju jeni mbretër të pyetjes, ata janë mbretër të përgjigjes.

Shkëlqim Cani – Kam idenë se është e vështirë të gjejmë degë apo shoqatë biznesi të organizuara, po të doni edhe takime individuale sa të doni, ku edhe unë personalisht kam bërë për këtë çështje dhe mund të them që të gjitha organizmat e biznesit e kanë artikuluar me siguri këtë çështje, për më tepër, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Kosovë. Shoqatat e biznesit edhe në Kosovë e kanë trajtuar...

(Diskutime pa mikrofon)

... për më tepër ju thashë, meqenëse pyetët po ju them për më tepër. Atëherë iu përgjigja pyetjes. Me shkrim, me gojë, me takime, me të gjitha mënyrat, të cilat janë prezent edhe kur marrim mendimet e biznesit për të gjitha çështjet që ne trajtojmë.

Arben Ristani – Ju thatë se keni marrë mendime me shkrim nga biznesi, a mund të na tregoni mendimet me shkrim, te cili biznes, kur e keni zhvilluar konsulencën e biznesit, dhe a mund të na i sillni këtu mendimet me shkrim që keni marrë nga biznesi lidhur me këtë çështje?

(Diskutime pa mikrofon)

Unë e kuptoj, por nuk është e hijshme të vish në parlament dhe të gënjesh, megjithatë ai e di vetë.

Dakord, e kuptova.

(Diskutime pa mikrofon)

Po, sepse nuk keni bërë konsultime me shkrim, në qoftë se do t'i sillni, sillini këtu, t'i shohim konsultimet që keni bërë.

Kisha një pyetje tjetër. Ju thatë që kjo kontratë e re që keni bërë ju zgjidh problemet me kontrabandën, sidomos me mallrat e akcizës, dhe ju thatë që zgjidh edhe problemet e mbrojtjes së kufirit, a diçka e tillë, në mos gabo. Çfarë kishte në ndryshim për këto dy pika kontrata e

kaluar që i zgjidhët ju me këtë kontratën e re? Pra, çfarë nuk zgjidhte në raport me kontrabandën kontrata e kaluar që e zgjidhët ju me kontratën e re?

Shkëlqim Cani – Unë u shpreha shumë qartë dhe, po të kesh mirëdashje, dhe këtë besoj që ju me atë që unë nënkuptova e incizoni, ju mund ta deklamoni në fund fare. Ju thashë, që nuk duhen fshehur edhe këto që kanë ndihmuar, dhe, siç ishte në kontratën ekzistuese, nuk fsheh që kjo kontratë përmban edhe këto elemente shtesë që ndihmojnë në luftën kundër kontrabandës, krimit, importit...

(Diskutime pa mikrofon)

E kishte si në të vjetrën, ashtu edhe në të renë. Më fal, se u shpreha jashtëzakonisht qartë për këtë, që nuk i shtoj vlera kontratës së re, por thashë, siç ishte në të vjetrën, edhe në të renë duhet marrë parasysh që kjo kontratë, veç anës tregtare për ato që unë thashë, kishte edhe këto elemente, pra i kishte dhe i ka. Ajo që ka vlerë, meqë e keni merak, është kursimi 100 ose 180 minimumi.

Arben Ristani – Një pyetje tjetër. Ju thatë se duke qenë që kontrata kishte vlerë për kontratë, për deklarata doganore, dhe se ju prisnit që deklaratat doganore të shtohen, do të thotë që do të shtohet vlera e kontratës, me aq sa unë e kuptova. Më thoni, në këta dy vjetët që ju jeni në qeverisje, sa janë shtuar deklaratat doganore në krahasim me vitet që ka qenë qeveria tjetër në qeverisje?

Irena Beqiraj – Deklaratat doganore janë rritur nga 5% deri në 13% dhe këto variojnë. Nga viti 2013 në vitin 2014 jemi rritur me 8%, sepse futen deklarata importi, eksporti dhe transiti. Unë e kuptoj që ju mund të bëni ndonjë lidhje direkt me të ardhurat, por futen edhe deklaratat e transportit. Me rritjen e kompondit ose të përbërë gjeometrike rriten mesatarisht 8% në vit. Kontrata, siç i kishte Rapiscan, që ishte numri i deklaratave herë 39, së cilës në ekonomi ne i themi kontratë e hapur, do të thotë se rritja e numrit të deklaratave do të çonte në mënyrë të menjëhershme në rritje të çmimit të kontratës. Minimalisht me rritjen më konservative 5%, që ishte vërejtur në 6 vjetët e fundit, atëherë ne do të shkonim në një kontratë, e cila do të shkonte 360 milionë euro.

Kur vlerësohet deklarata, është 15 vjeçare, nuk është për dy vjet, zoti deputet. Për 15 vjet kjo kontratë mund të shkonte 365 milionë euro me rritjen më minimale të vërejtur në këta 6

vjetët e fundit, ndërkohë me rritjen vjetore gjeometrike me 8% do të vinte 425 milionë euro. Pra, minimalisht...

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem, a mund ta mbaroj sepse është shumë e rëndësishme. Atëherë, çfarë bëmë gjatë këtyre negociatave? Norma e brendshme e kthimit të këtij projekti për 15 vjet shkonte 12,5%, ndërkohë kemi ulur normën e brendshme të kthimit për Rapiscanin në 5%, kemi vendosur një tavan për kontratën që shkon në 207 milionë euro, dhe besoj që ky është një kursim që ia sollëm qeverisë dhe biznesit shqiptar.

Shkëlqim Cani – Edhe një herë, kjo kontratë u bë e mbyllur, nuk merr Rapiscani mbi 210 milionë euro. Çfarëdo të ndodhë në 15 vjet, le të rritet numri i deklaratave...

(Diskutime pa mikrofon)

Zoti kryetar,

Kam një merak. Unë jam treguar konservator për t'iu përshtatur natyrës sime dhe për të qenë korrekt me Kuvendin, sepse 15 vjet ikin dhe njerëzit mund t'i kthehen mbrapsht edhe fjalës time, pasi dikush do ta bëjë vlerësimin. 100 deri në 180 milionë euro është kursimi konservator, nuk e luan topi, nga kontrata e vjetër me kontratën e re, pra shqiptarëve, ekonomisë shqiptare, biznesit shqiptar, publikut shqiptar se në fund do ta paguajë ky i fundit te çmimi i mallrave, u janë kursyer 100 deri në 180 milionë, dhe ky është vlerësim konservator. Kushdo që të bëjë optimistin dhe realistin, atëherë shifrat luhaten më tej, pra shtohen.

Faleminderit!

Arben Ristani – Pyetja e fundit. Ju thatë se avokatia e Shtetit është paguar 500 mijë euro, por me dijeninë time është paguar kompania e Blerit me 500 mijë euro. Tani a mundet që ta rinegocionit këtë pa ju thënë ose pa ia dhënë Blerit 500 mijë euro, që t'ju thoshte se nuk fitoni gjë me këtë çështje dhe t'i hynit...

(Diskutime pa mikrofon)

Gruaja e Toni Blerit, avokatja. E rëndësishme është që paratë nuk i ka marrë, pasi u tha që u pagua avokatia e Shtetit, është paguar e shoqja e Toni Blerit. Para se ajo të merrte 500 mijë euro dhe të thoshte, mbylle këtë histori, se nuk ecën më tutje, a nuk do të ishte më mirë të negocionit vetë dhe të shikonit nëse ecni dot më tutje apo jo, dhe t'ia kursenit popullit këto 500 mijë euro që harxhuat me gruan e Toni Blerit?

Shkëlqim Cani – Ju e keni të lehtë kur ofendoni, kurse unë e kam shumë të vështirë dhe nuk e kuptoj...

(Diskutime pa mikrofon)

Ju jeni mësuar me këto lloj debatesh, më ofenduat sepse më thatë gënjen, kurse unë e kam shumë të vështirë, që t'ju them se gënjen. Jo, e kaloj, por nuk ka kaluar kjo tjetra që më thatë, se unë paskam thënë që avokatit të Shtetit i dhamë 500 mijë euro. Si u dhënkam.

(Diskutime pa mikrofon)

Tani gënjeni ju, se unë këtë nuk mund ta them, sepse nuk e di si i jepen, teknikisht nuk i jepen avokaturës, pasi ajo paguhet në një mënyrë tjetër, dhe kuptohet që i ka marrë OMNIA, por i gjithë halli është se ju jeni shumë të shqetësuar për 500 mijë euro, pasi ju jeni juristë. Edhe unë ashtu them, pse gjithë ata njerëz që hyjnë nëpër gjyqe përse i marrin dhe i paguajnë avokatët, ç'punë kanë avokatët kur çështja është shumë e qartë, pasi ka vendim gjyqi. Edhe unë ashtu them që paguajnë, po ja që e tërë puna juaj është e lidhur me këtë, dhe për këtë mjafton që të më pyesni mua, pasi përgjigjja për këtë është shumë e thjeshtë. Jeni të shqetësuar për 500 mijëshen, thoni faleminderit për 100, 180 milionët dhe pastaj publiku le ta bëjë analizën e kësaj politike.

Fatmir Xhafaj – Fjalën e ka zoti Fino dhe më pas ta mbyllim.

Bashkim Fino – Kam pyetje. Jo, nuk ka pse ta mbyllim pasi më pas do të ketë diskutime. Madje, unë çuditem sesi opozita bën pyetje, por unë kam një pyetje dhe jam pak më radikal sesa këta, sepse kjo mua nuk më intereson fare.

Zoti Ministër,

Në qoftë se ne kemi bërë gabim, e kam fjalën për deputetët e vjetër që kemi votuar në Kuvendin e kaluar, ku afati i kësaj kontrate nuk kishte kohë përfundimi, dhe ky është një gabim që është bërë nga Kuvendi kur është miratuar diçka e tillë, kjo do të thotë që mund ta aprovojmë, e para, pa bërë gjithë këto negociata dhe sforcim të madh, sepse ti duhesh vlerësuar në bazë të urdhrat të Kryeministrit.

Pyetja e dytë që unë kam, je njeri politik dhe këtë përgjigje duhet të ma kthesh, pasi nuk e pres nga opozita, është tërësisht politike. Pse interesohet kaq shumë opozita që të mos i kursejmë këto 100 deri në 180 milionë euro? Çfarë ka opozita që thotë jo, mos i kurseni këto 100, 180 milionë euro, por le t'i marrin ata që vazhdojnë ta kenë këtë biznes? Cila është arsyeja? Kjo është pyetje politike dhe është për ty, zoti Ministër, mos fol ti se e kam unë fjalën, po të

duash unë mund të flas në diskutimin e radhës dhe do ta bëj. Cili e ka këtë biznes, pse e ka këtë biznes dhe pse interesohen këta tani që po u ikën 100, 180 milionëshi, atë që ju thatë, minimalisht në mënyrë konservative. Këto dy pyetje kam. A më kthen dot një përgjigje politike?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Fino.

Zoti Ministër!

Shkëlqim Cani – Çështja e kontratës së hapur ishte gabim dhe kjo është e sigurt, por që të abrogohet një kontratë, pasi nënshkruhet, miratohet nga qeveria dhe Kuvendi nuk është kaq e lehtë pastaj që të abrogohet.

(Diskutime pa mikrofon)

Po, e keni bërë gabim dhe, meqë e doni politike përgjigjen, i është bërë dëm popullit shqiptar për 100, 180 milionë minimumi.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit.

Kam respektin për opozitën edhe për ju.

Zoti Ministër!

Shkëlqim Cani – Besoj se në këtë rast bie dakord edhe me deputetin Nard Ndoka, që duhet të jetë veprimtari armiqësor e deputetëve që e mbrojnë. Pra, kur del hapur që ne i ulëm 100, 180 milionë. Ta mbrosh pse u ul 180 milionë nga qeveria një kontratë që nuk duhej mbrojtur, kjo nuk ka vend. Më duket një pozicion shumë i vështirë i atyre që duan ta mbrojnë kontratën ekzistuese.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit.

A ka diskutime?

(Diskutime pa mikrofon)

Oerd Bylykbashi – Zoti Ministër,

Ju erdhët sot këtu për ta paraqitur këtë kontratë si një arritje të qeverisë apo të ministrisë, por, në fakt, është një dështim i turpshëm i ministrisë, sepse ju vetë e pranoni që thyhet një marrëveshje, një kontratë, rrezikuar që Shqipëria të paguajë 360 milionë në Arbitrazh dhe këtë ta paguajë pa marrë asnjë lloj shërbimi. Jo vetëm kaq, por me prishjen e kontratës, ju vetë nënkuptuat që, duke mos pasur këtë kontratë me garancitë dhe siguritë që jepte për kufirin shqiptar, për doganat, për luftën kundër korrupsionit, kontrabandës, ju ishit të ndërgjegjshëm, në fakt kur e bëtë këtë, jua thamë ne në atë kohë, por vinit në diskutim integritetin e këtyre

procedurave duke i lënë të zbuluar kufijtë në mënyrë që njerëzit, të cilët janë qëllimkëqij në pazare me qeveritarët, ta kapërcenin kufirin, të bënin të gjitha shkeljet e kufirit, kontrabandën e të tjera. Ndërkohë, ju tundnit flamurin se po u tregonit vendin amerikanëve, dhe për këtë duke na thënë që keni bërë marrëveshje, negociata, keni folur individualisht edhe me një listë të gjatë biznesmenësh të caktuar, por askush nuk i di, pasi është shumë okulte e gjithë kjo.

Nuk do as mend as kalem që ju keni qenë përpara, ose nuk e bëtë fare të qartë këtu, ose do të na linit të ekspozuar përpara një kontrabande galopante, ose do të bënit një marrëveshje tjetër me dikë tjetër që ju interesonte juve, sepse ju e thatë, që mund të negocionit me dikë tjetër.

Zoti Ministër, ndoshta nuk jua kërkoj dot juve, sepse është koncept juridik koncepti i sigurisë juridike, të cilin qeveria juaj e ka shkelur dhe thërrmuar praktikisht dhe ky është vetëm një nga rastet. Në dy vjet kemi parë një katastrofë me të gjitha marrëveshjet dhe raportet e tjera, të cilat janë cenuar dhe dërrmuar duke thërrmuar pikërisht parimin e sigurisë juridike, parim kushtetues ky, prandaj jeni detyruar, sepse dikush ju ka nxjerrë në dorë një kontratë dhe ju ka thënë: “Zotërinj, ju keni një dokument të firmosur nga qeveria shqiptare, me vulën e parlamentit shqiptar dhe ne i qëndrojmë kësaj”, dhe keni ulur kokën. Këtë jua ka thënë edhe konsulenca e kompanisë britanike, të cilën ju e keni paguar, por unë nuk e kuptoj paaftësinë ose dashakeqësinë në moskuptim të diçkaje që e kuptojnë të gjithë edhe studentët e juridikut, që një kontratë respektohet, një kontratë prishet atëherë kur ka kushte ekstreme. Një qeveri nuk mund të dalë kollaj, ashtu siç e pranuat edhe ju vetë mbi vullnetin e parlamentit. Prishja e kontratës karakterizon një formë të thekur keqbesimi, e për rrjedhojë na njollos dhe na nxin fytyrën ne në zbatimin e këtyre marrëveshjeve në përgjithësi me kompanitë e huaja, dhe sigurisht që dëmton edhe besimin e tyre në seriozitetin e shtetit shqiptar. Por, duke qenë se parimi i sigurisë juridike është parim juridik, kushtetues të paktën, ka edhe një koncept që është edhe politik.

Zoti Ministër, *Pacta sunt servanda*, faktet shërbejnë, zbatohen e për rrjedhojë ju keni qenë të ndërgjegjshëm, keni qenë të gatshëm të paguanit çmimin që do të kishte prishja e kësaj kontrate, për të gjitha ato benefite të paligjshme që do t’i vinin kësaj qeverie nga mosmbrojtja e kufirit me një shërbim të tillë. Ju vetë e thatë, që atë që bën vetë shteti shqiptar, që herë punon e herë nuk punon, por ndërkohë ne kërkonim që të kishim diçka që është funksionale. Për rrjedhojë, nuk keni bërë gjë tjetër veçse jeni kthyer me bisht ndër shalë dhe vetëm për shkak se

kompania amerikane ka dashur t'ju japë koncesione, sot vini për të justifikuar këtë turp, për të na thënë që kursyem kaq e aq.

Edhe një herë po ju them, kini parasysh se, përveç kostos që ju ka kushtuar, përveç rrezikut që na ekspozuat, ju do të ishit shumë të lumtur që në doganat shqiptare të mungonin jo ato shifra që mungojnë sot, nga ajo që pritej të inkasonit nga importet në mënyrë të posaçme nga duhani, karburantet dhe që nuk i ka buxheti shqiptar. Imagjinoni si do të ishte kjo shifër nëse ne do të kishim një kohëzgjatje akoma më të madhe nga një kokëfortësi e kësaj qeverie, në prishjen e kontratës dhe në zgjatjen e arbitrazhit. Ju desh t'ju thoshte një firmë e huaj për ta kuptuar që ishit gabim nga fillimi deri në fund. Në fund fare duhet të pranoi edhe në heshtje, që nuk është veçse një veprim dhe një dështim i turpshëm i kësaj qeverie, gjë që ka ndikuar negativisht në mënyrën sesi na shohin ne partnerët e huaj në lidhje me kontratat që bëjmë. Qeveria nuk fillon me ju, zoti Ministër, me qeverinë tuaj dhe aq më shumë raportet, marrëdhëniet me partnerët bazohen mbi veprimet çëgevariste si puna e këtij që sot po na detyroni ta rishqyrtojmë.

Fatmir Xhafaj – Fjalën e ka zoti Halimi!

Më pas zoti Fino.

Eduard Halimi – Faleminderit!

Diskutimi dhe relacioni sot duhet të fillonte me një falje të madhe, të cilën ndoshta nuk duhet ta bënte zotëria në karrigen e ministrit, pasi para dy vjetësh ka qenë askushi, por deputetët të cilët kanë diskutuar dhe kanë qenë pjesë e diskutimeve në parlament dhe kanë patur kryetar Edi Ramën, i cili, kur kjo marrëveshje është miratuar, ka nxjerr në podiumin e Partisë Socialiste me dhjetëra deputetë dhe po citoj njërin prej tyre në deklaratat e vitit 2013: “Kjo kontratë është kontratë korruptive. Qeveria socialiste, kur ne të vijmë në pushtet, do ta bëj këtë shërbim publik. Kjo praktikë do të marrë fund” - thotë ai, sepse ishte rilindas atëherë dhe tani e keni harruar. “Atdheu, thotë kryerilindasi – kthejani shqiptarëve. Në rast se nuk e bëni ju, do ta bëjmë ne. Atdhe të privatëve nuk mund të ketë. Atdheu duhet të jetë publik dhe i shqiptarëve”. Këtë ka thënë ky trim i madh, rilindasi në vitin 2013 kur është miratuar kjo kontratë. Sigurisht, broçkull ka qenë atëherë për t'u hedhur hi sy shqiptarëve, se kur të vinin këta në pushtet, rilindasi së bashku me kryerilindasin do t'ua kthenin atdheun shqiptarëve. Ja pra, atdheun nuk ua kthyen shqiptarëve. Tani fillojeni me një ndjesë të madhe, në mos këtu nuk e bëtë, hidhuni një sy deklaratave kur nuk keni qenë në Partinë Socialiste, hidhuni një sy të gjitha pamfleteve që kanë

lexuar deputetët në podiumin e Partisë Socialiste, dhe, kur të ketë parlament, fillojeni me një ndjesë të madhe drejtuar shqiptarëve.

Kontrata nuk ka qenë kontratë korruptive, pasi kjo u tregua për dy vjet jo nga ju, por nga arbitrazhi ndërkombëtar se kontrata ishte e ligjshme. Kontrata ka pasur si synim të mbronte pikërisht shtetin dhe qytetarët shqiptarë nga trafiku, nga trafikimi, nga kontrabanda që për dy vjet ju nuk e bëtë dhe ky është fakt. E gjithë historia se në kontratë paska pasur një shifër prej 316 milionësh dhe në këtë marrëveshje, të cilën e lexova gjatë kohës që zoti Xhafaj tha se kishte ardhur në *e-mail*, ishte e vërtetë që kishte ardhur, nuk ka shifër as 316 dhe as 206 milionë, nuk ka në këtë marrëveshje, në qoftë se është, ma tregoni ose ma sillni në parlament. Flitet vetëm në atë që ju proklamoni këtu, ndërsa ka një shifër që ka të bëjë pikërisht...

Fatmir Xhafaj – Ka shifër për njësi, shumëzohet.

Eduard Halimi – ... ka një shifër që është shifra e pagesës së shpenzimeve gjyqësore, e studiove dhe me radhë në të cilën sigurisht duhet të gjenden përgjegjësitë. Ka të drejtë, zoti Bylykbashi, në qoftë se ju e dinit se këtu nuk shahet, sepse kontrata, siç do t'u thoni shqiptarëve, nuk ishte e kundërligjshme, se kontrata nuk ishte korruptive se po nënshkruani prapë me të njëjtët njerëz ju, atëherë sigurisht ka vetëm një shifër, që kjo shifër është pikërisht ajo 500 a 600 mijë, e cila është paguar dhe ka ikur nga xhepat e qytetarëve shqiptarë.

Doja ta mbyllja fjalën duke thënë se kontrata e para dy vjetve ka qenë një kontratë po aq e ligjshme, po aq kushtetuese, ka marrë miratimin dhe bekimin e Kuvendit, siç po thoshit sot, por tregon edhe një herë sesa të pafytyrë jeni ju bashkë me kryerilindasin, kur të tjera gjëra i thonit popullit para se të bënit zgjedhjet dhe, kur vini këtu, pasi fitoni zgjedhjet, u thoni të tjera broçkulla.

(Diskutime pa mikrofon)

Broçkullat qytetarëve shqiptarë, se atdheun do t'ua kthenit me Rilindjen, dilni tani ditën e enjte dhe kërkojuni falje.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Fino!

Bashkim Fino – Do t'u kthej monedhën këtyre pafytyrësve që po flasin këtu me një gjë shumë të thjeshtë. Është e vërtetë që kemi bërë deklarata të tilla në vitin 2013 para se të vinim në pushtet, pasi ka shumë kontrata abuzive që janë bërë në kohën e regjimit të tyre dhe jo pa qëllim

e bëra pyetjen për ministrin, dhe e bëra politikisht, i cili u detyrua të thoshte që po, kam bërë një dosje dhe e kam çuar në prokurori, të cilën ne duhet ta lëvizim sa më shpejt, një dosje të tillë kur shohim që ka një aktivitet të tillë.

Unë mendoj dhe isha radikal kur bëra pyetjen...

(Diskutime pa mikrofon)

Zoti kryetar, do të mbani qetësi!

Fatmir Xhafaj – Unë mbaj qetësi për ata që kuptojnë nga qetësia, por atyre që nuk kuptojnë nga qetësia nuk kam se çfarë t’u bëj.

Bashkim Fino – Më radikal do të isha që të paguhej gjoba 360 milionë dhe të kthehej kontrata nga e para, sepse të bësh kontratë të hapur, kur edhe vetë këta që folën e kanë votuar dhe kanë diskutuar me zell të madh, ka hile të hapur brenda të bësh një kontratë të hapur. Pra, unë jam më mirë që të paguajmë gjobën dhe ta kthejmë kontratën nga e para, që ta marrin vesh se çfarë bëhet kur ke një maxhorancë, por nga ana tjetër çfarë na thanë këta. Këta thanë që ju, zoti Ministër, jeni i dështuar, madje na thanë që jeni i korruptuar? Po ku është dështimi i korruptuar. Për mua, ju, zoti Ministër, jeni vonuar, jeni vonuar edhe në çuarjen e dosjes në prokurori, e keni vonuar dy vjet, duhet ta kishit bërë që vitin e parë, për këtë po, unë mund të bëj vërejtje për ju, por jo i dështuar. Ju sot vini dhe na sillni një kontratë ku u thoni shqiptarëve që do të shpëtojmë 100 deri në 180 milionë euro minimumi në mënyrë konservative, siç e thatë ju, dhe jo pa qëllim ta bëra pyetjen, pse irritohet kaq shumë opozita dhe nuk do që ne t’i kursejmë këto 180 milionë euro? Kush fshihet mbrapa kontratës amerikane? Cilët janë? Janë familjarët e tyre, të udhëheqësve të tyre që po fitojnë, dhe kanë fituar dy vjet. Fituan edhe këta dy vjet në pushtetin e socialistëve dhe po bëjnë zhurmë të madhe sot, se nuk duan të kthehen dhe të kursehen 180 milionë euro, pasi duan ende të marrin lekë. Prandaj them, më mirë të bëhej gjoba 360 milionë euro dhe të kthehej nga e para e gjithë kontrata dhe pastaj të shihja sesi do të flisnin këta opozitarët e sotëm. Sot këta nuk duhej të flisnin fare, sot këta duhej të rrinin sus dhe të thoshin shyqyr qylit i ramë, që kaluam edhe dy vjet me socialistët dhe u morëm ca lekë të tjera. Sot duhej të flisnim ne dhe t’ju kërkonim falje që nuk e bëmë ditën e parë, ne t’u kërkonim falje të gjithë deputetët e vjetër, që kemi miratuar një kontratë të hapur në parlamentin shqiptar.

Një kontratë e hapur nuk mund të miratohet pa pasur një afat kohor, të cilin sot ne vijmë dhe e rregullojmë me këtë projektligj të caktuar. Ky është diskutimi im, që ta kuptojnë shqiptarët,

dhe nuk është diskutim për të bërë se çfarë kemi thënë ne në vitin 2013 dhe çfarë nuk kemi bërë ne. Kemi kohë, zotërinj të opozitës për të bërë, kemi shumë kohë ende përpara për të bërë shumë nga gjërat, të cilat mbasi deri tani nuk i kemi bërë, por ato që kemi premtuar në vitin 2013, nuk e kemi mbyllur ende mandatin, por mjerë ju.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Fino!

A ka diskutime të tjera? Nuk ka.

Unë jam shumë i keqardhur për këtë situatë të përfaqësuesve të opozitës, jam vërtet i habitur sesi mund të flasësh këtu për të kursyer 100, 180 milionë euro dhe opozita të jetë e shqetësuar për formën e marrëveshjes, pse nuk u kemi marrë dorën para apo mbrapa.

Sa më përket mua, po ta them që sot që ta dëgjosh sot edhe nesër, as kam qenë dhe as jam për koncesione të tilla, për përgjegjësi që duhet t'i marrë shteti. Nuk kam qenë dje, nuk jam sot dhe nuk do të jem as nesër dhe të gjitha këto janë korrupsione të pastra, në vlerësimin tim. Këto lekë duhej t'i merrte dhe duhet t'i marrë shteti në çdo rast, dhe shteti duhet të mbajë përgjegjësi për taksat e taksapaguesve shqiptarë. Shteti nuk mund të lëshojë kaq lehtë detyrat, përgjegjësitë e veta në funksion të interesave të disa individëve.

Nga ana tjetër, unë e kam ndjekur të gjithë këtë debat dje, po e ndjek edhe sot. E kam ndjekur dje, në mos e kam kontaktuar siç ka pasur ministri dhe ka bërë shumë mirë për shkak të detyrës me komunitetin e biznesit, e kam ndjekur nëpër media dhe nuk mund ta quajë sesi mund të mos përshëndetet një fakt i thjeshtë, deri dje pagoje 39, sot do të paguash 22. Është fakti më i thjeshtë në botë, pra 17 euro më pak. Për një biznesmen këto nuk janë pak, ndoshta për disa njerëz këto janë çikërrima, por unë mendoj se për ata që e kanë me djersën e ballit janë shumë, dhe ne duhet ta respektojmë këtë fakt. Mund të ishte bërë edhe kështu siç thotë zoti Fino, e mira do të ishte të mos ishte bërë fare dhe të mos vazhdojnë të bëhen më të tilla koncesione të kësaj natyre, por gjithsesi edhe për kaq sa është bërë, u duhet thënë: Faleminderit dhe përgëzime, zotërinj të qeverisë, zotërinj të Ministrisë së Financave!

Gjithsesi, secili ka pikëpamjen e vet, e rëndësishme është që janë qytetarët ata, të cilët na gjykojnë dhe na votojnë.

Kush është dakord në parim? Kundër? Një kundër. Abstenime? Dy abstenime.

Miratohe në parim të dy projektligjet.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? S'ka. Abstenime? S'ka.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? S'ka. Abstenime? S'ka.

Neni 3. Kush është dakord? Kundër? S'ka. Abstenime? S'ka.

Neni 4. Kush është dakord? Kundër? S'ka. Abstenime? S'ka.

Në tërësi për projektligjin? Kundër? Një kundër. Abstenime? Dy abstenime.

Miratohet në tërësi projektligji.

Mbyllet edhe kjo pikë e rendit të ditës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

***Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike
dhe të Drejtat e Njeriut***

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 06.07.2015, ora 16:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për turizmin”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Vasilika Hysi, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Petrit Vasili, Silva Caka, Eduart Halimi, Arben Ristani, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Pirro Lutaj, Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Dashamir Peza, Anila Agalliu, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Ervin Mete - zëvendësministër i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Ardit Çollaku - këshilltar i ministrit në Ministrisë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Sonia Popa - drejtore e Përgjithshme e Turizmit pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Alma Baze - drejtore e Standardizimeve për Turizmin pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Enton Diamanti - përgjegjës sektori pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Fatmir Xhafaj – Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës: projektligjin “Për turizmin”. Vazhdojmë me nenin 8.

Po keni fjalën, zoti Fino!

Bashkim Fino – Neni 8. Ne kemi dy sugjerime:

E para, pika c, Komiteti Këshillimor i Sektorit Privat të Turizmit. E keni parasysh nenin 8? Ka pyetje?

Fatmir Xhafaj – Atëherë 7 të parat i kemi kaluar dhe tani jemi te neni 8. Vazhdoni, zoti Fino!

Bashkim Fino – E para, Këshilli i Ministrave nuk del si organ përgjegjës për turizmin, duke pasur parasysh, që turizmi është një nga sektorët prioritar të ekonomisë. Roli dhe përgjegjësia e Këshillit të Ministrave duhet të jetë më i madh, dhe unë mendoj se duhet të ishte shënuar këtu, megjithatë këtë e gjykoni ju.

E dyta, vërejtja që kam unë është te germa c), Komiteti Këshillimor i Sektorit Privat të Turizmit. Si mund të jetë Komiteti Këshillimor një organ përgjegjës? Nuk mendoj se është organ përgjegjës në fushën e turizmit, por është thjesht organ këshillimor dhe le të jetë atje ku duhet të jetë në nen, por jo këtu. Këto dy sugjerime kam.

Fatmir Xhafaj – Po, jemi dakord të vendosim Këshillin e Ministrave, pasi mendoj se nuk është esenciale kjo gjë dhe mendoj se ka të drejtë, zoti Fino.

Faleminderit, zoti Fino!

Ervin Mete – Nuk është praktikë që të vendoset Këshillin e Ministrave, sepse do të ishte në ligj, megjithatë e shohim këtë pjesë.

Fatmir Xhafaj – Strategjinë e miraton Këshilli i Ministrave.

(Diskutime pa mikrofon)

Petrit Vasili – A mund të bëj vetëm një pyetje? Nenet përfundimtare me organet përgjegjëse janë këto apo ka ndryshime të tjera? Lidhur me organet përgjegjëse për atë çka përmban neni 8 është ky apo ka shtesa?

Fatmir Xhafaj – Unë këto kam përpara. Po të keni ju ndonjë gjë?

Petrit Vasili – Jo unë nuk kam, por u pretendua një shtesë në diskutimin në parim.

Fatmir Xhafaj – Atë të zotit Fino?

Petrit Vasili – Nuk e di!

(Diskutime pa mikrofon)

Bashkim Fino – Më falni, se më shpëtoi kjo pjesë! E para, unë bëra një pyetje jo shtesë dhe këta e kanë shtuar këtu Agjencinë Kombëtare të Bregdetit. Unë bëra një pyetje duke menduar që e keni parasysh atë kalimin e Ministrisë së Turizmit nga Ministria e Zhvillimit Urban te Ministria e Ekonomisë.

E dyta, Ministria e Turizmit është krijuar para një viti me vendim qeverie dhe unë pyeta: “Tani që Ministria e Turizmit, që i ka tashmë gjithë këto agjenci, do ta fusë AKB-në, apo jo”? Këta ishin të pa informuar dhe më thanë: “Do interesohemi, do ta sjellim dhe do ta fusim”. Tani shoh që këtu e kanë futur dhe në këtë moment unë si relator kam pyetje të tjera për të bërë dhe falënderoj Petritin që më ndihmoi. Pse kam pyetje? Problemi i parë ngrihet, se që nga momenti i parë që ti e vure AKB-në këtu, do të thotë se ta diktua me që vure.

E dyta, më kryesorja dhe me çfarë kam lexuar unë lidhur me funksionet është se Agjencia Kombëtare e Bregdetit është një agjenci, e cila për mendimin tim krijohet në një kohë të caktuar, në një rrethanë të caktuar dhe në një moment, që mund ta mbyllë aktivitetin e vet pas 6 muajsh, apo pas një viti. Si e tillë nuk ia prek njeri të drejtën Këshillit të Ministrave, të krijojë disa agjenci të tjera kur t’i interesojë, si në rastin konkret. Kjo gjë duhet parë me kujdes nga qeveria sepse AKB-ja nuk ka ardhur nga ajo, por është e shkruar në ligj dhe duhet parë me kujdes, që ne ta kemi të qartë nëse do jetë, apo jo?

Unë mendoj se në momentin që ai e ka ngritur si agjenci me vendim qeverie, fare mirë mund ta fuste në ligj më parë. Këtu ka ngelur edhe diskutimi që ne kemi bërë, për sa i përket agjencisë.

Unë i kam të shënuara këtu kompetencat e Agjencisë Kombëtare të Turizmit te neni 14/1 që doni të shtoni ju dhe kjo ka vetëm tre kompetenca:

E para: “Agjencia Kombëtare e Bregdetit në vijim AKB, është personi juridik publik, buxhetor me seli në Tiranë në varësi të ministrit përgjegjës për turizmit, që ka për qëllim mbrojtjen dhe ndjekjen e zhvillimit të zonës bregdetare shqiptare.”

E dyta: “Mënyra e organizimit dhe funksionimit të AKB-së, miratohet me vendim të KM-së dhe me propozim të ministrit përgjegjës për turizmin.”

E treta: “Struktura dhe organika e AKB-së, miratohet me urdhër të Kryeministrit me propozim të ministrit përgjegjës për turizmin.”

Kjo do të thotë, a duhet të jetë këtu në ligj? Në mos gaboj, ju, kryetar i latë kohë dhe thatë: “Ta shikojnë dhe ta sjellin më vonë, e të tjera.” Këta e sjellin duke e futur në ligj dhe mua më duket se kjo lloj futjeje është pak artificiale, pasi ministri i Turizmit duhet ta ketë vizionin e qartë nëse duhet të jetë këtu apo kjo agjenci është ngritur thjesht në një moment të caktuar për një kohë të caktuar dhe nesër mund të pushojë së vepruari si agjenci.

Unë i lexova edhe kompetencat e AKB-së, të cilat janë kompetenca të përgjithshme me Agjencinë e Turizmit. Tani a do të kemi dy agjenci apo do të kemi një të mirëfilltë? Kjo është pyetja, që unë bëj tani, se këta të Ministrisë së Turizmit nga një pyetje që bëmë ne, erdhën dhe e futën në ligj. Në ligj e kanë futur në këto momente, pra nuk ka ardhur nga KM-ja për hir të së vërtetës. Kjo është e vërteta, apo jo?

Petrit Vasili – Kam për të thënë një konsideratë lidhur me këtë çështje. Unë, edhe kur e diskutuam herën tjetër, kisha një shqetësim shumë të fortë lidhur me këtë problematikë të kësaj agjencie dhe mendoj që ne do ta shterojmë këtë diskutim për këtë çështje duke e konsideruar pa vend edhe jashtë të gjithë strukturës që ka ligji sepse i gjithë ligji “Për turizmin” është ndërtuar mbi këto organe dhe zbërthen mënyrën se si ky ligj do të përballohet nga këto organe përgjegjëse në këtë fushë.

E gjitha kjo është një histori e një mungese serioziteti të jashtëzakonshëm dhe unë nuk e kuptoj, kjo është një agjenci, që i ka mbetur dikujt në derë dhe nuk ka ku ta çojë, por ne nuk kemi pse të bëhemi ortak me këtë histori.

Në këtë konstrukt të këtij ligji kjo agjenci nuk rri gjëkund dhe hartuesve të ligjit nuk u ka qëndruar gjëkund ndaj dhe nuk e kanë sjellë dhe kanë bërë shumë mirë. Kështu që, unë them të ecim më tutje, ky nen është shumë solid në këtë propozim, madje unë në materialet e mia nuk e kam fare këtë ndryshim dhe prandaj pyeta pasi nuk po e shikoja. E gjithë struktura dhe konstrukt i ligjit qëndron mbi këtë organ, që kanë zbërthyer dora-dorës të tërë rolin që kanë në gjithë këtë proces të administrimit të turizmit në vend.

Problemet që kemi si agjenci është, ka të drejtë zoti Fino, kur thotë: “E përkohshme, jo e përkohshme, me një mandat të kufizuar e të tjera”, me raportet e forta që ajo ka me çështjet e rregullimit dhe planifikimit të territorit në mënyrë të veçantë në këtë zonën përkatëse që ka lidhje dhe me bregdetin, por ka plot funksione të tjera, që nuk lidhen fare me ligjin, ta shikojmë me gjakftohtësi ministria përkatëse e rregullimit të territorit pasi ajo ka funksione të spikatura dhe mund të gjejë strehim atje, meqenëse ka mbetur një agjenci çuditërisht pa strehim dhe kjo është një çudi e paparë që po dëgjojmë dhe ne të ecim më tutje me miratimin e ligjit dhe të mos merremi më me këtë histori, e cila nuk ka as seriozitet burokratik, as legjislativ dhe asgjë tjetër të kësaj natyre.

Fatmir Xhafaj – Po, zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Në fakt edhe unë këtë shqetësim kisha, ndërkohë që kam një pyetje, së cilës mund t’i përgjigjet zëvendësministri.

AKB-ja në raport me AKT-në kanë mbivendosje kompetencash? Nëse për shembull, lihet vetëm AKT-ja dhe nuk përfshihet AKB-ja, a dëmtohet kjo pjesa e kompetencave ose e organeve përgjegjëse në fushën e turizmit?

Ervin Mete - Së pari, pozicioni ynë është që AKB-ja duhet të bëhet pjesë ligjit dhe është e vërtetë që për shkak të kalimit të kompetencave nga Ministria e Zhvillimit Urban në Ministrinë e Ekonomisë, tashmë edhe të Turizmit, ka pasur diskutim nëse për nga natyra e saj kjo agjenci ka më shumë karakteristikat e një trupe, që kontrollon zhvillimin urban, të territorit apo pjesën e turizmit. Fakt është se me në një vendim të KM-së ka kaluar më vonë si agjenci dhe nuk është se ka ngelur e pa pozicionuar, por është pjesë e Ministrisë së Turizmit dhe për nga natyra e saj ne mendojmë që edhe për funksionet që kryen, kryesisht në zonën bregdetare integrohet me logjikën tonë të ligjit dhe duhet të jetë pjesë e tij.

Për sa i përket mbivendosjes ose jo me AKT-në, përgjithësisht AKT-ja kryen funksione promovimi, pra kryen funksione të përmirësimit apo rritjes së imazhit të Shqipërisë kurse AKB-ja kryen funksione monitorimi, funksione terreni, të cilat ne mendojmë se janë komplementare dhe të domosdoshme për t’u pasur në suazën e kontrollit të strukturave turistike, por edhe të mënyrës se si operohet në zonë bregdetare.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Vasili!

Petrit Vasili – Problemi është i tillë, pasi unë besoj që edhe zëvendësministri me shumë dashamirësi do që ta shtrëngojmë që ta sjellim në udhën e ligjit. Dispozitat e ligjit janë këto: qëllimi i ligjit është që të promovojë Shqipërinë si destinacion turistik, të tërheqë vizitorët e huaj dhe të zhvillojë një turizëm të qëndrueshëm, duke siguruar që ofruesit e shërbimeve të përmbushin kërkesat e turistëve.

E para, promovimin, edhe si detyrë kryesore, AKT-ja e ka këtë funksion të përshkruar në ligj dhe kryen më së miri. Vjen problemi i inspektimit të territorit dhe meqenëse ministria e ka sjellë këtë punë, kemi një inspektorat që mbulon fushën e turizmit. Sa inspektorate do ta mbulojnë këtë fushë?

Një nga hallet e mëdha që ka pasur ky shtet dhe që është përpjekur ta evitojë, ka qenë mbivendosja e kontrollit të territorit. Ne kemi një inspektorat të parashikuar në ligj, por ngaqë nuk kemi çfarë të bëjmë se na ka mbetur AKB-ja dhe duhet që t'i gjejmë funksionet.

Zoti Mete, kjo është një histori që nuk ngjit! Tani në qoftë se ka një merak të caktuar, gjëra të caktuara, subjektive, mos na i vini këtu në ligj dhe na bëni ne joseriozë. Këto janë të përcaktuara qartë kush e kontrollon, kush e monitoron, kush e bën promocionin, kush ka arsye politike, pra secila tullë në strukturën e ligjit ka edhe aktorin përgjegjës dhe tani ne meqenëse na ka mbetur edhe kjo agjenci, hajdeni ta hedhim brenda. Nuk është kështu ligji, zotëri! Më vjen shumë keq dhe çuditem se si vazhdoni që të insistoni me këtë gjë. Unë po ju them, jo vetëm që kjo është një histori joserioze, por edhe sikur maxhoranca e votave të jetë kundër kësaj ideje, ne edhe në sallën e parlamentit do ta stigmatizojmë në maksimum dhe nuk duhet të vijmë kurrë më nisma të tilla.

Një institucion i tërë, thotë që nuk kemi ku ta bëjmë dhe hajde ta plasim aty brenda, te ky thesi, se ky thesi thotë turizëm. Ti e ke të gjithë strukturën e ligjit të qartë. Secili e ka të qartë detyrën se çfarë do të bëjë dhe shumë mirë e keni bërë, dhe unë e përshëndes. Tani ne themi do të kontrollojmë, po çfarë do të kontrollojmë? Po Inspektoratin e Turizmit do ta fshijmë? Hajdeni pra, ta heqim inspektoratin që mbulon turizmin, por kemi edhe këtë AKB-në. Hajde se po heqim Komitetin Këshillimor dhe po ia japim AKB-së, AKT-ja të japë promocionin e tij se ky bën disa fotografi ishujsh dhe disa histori të caktuara dhe këtyre drejtuesve shëtitës, që nuk kanë çfarë të bëjnë, u gjejmë një vend në ligj. Nuk bëhet kështu shteti! Ne për këtë seriozitet kemi ardhur këtu si maxhorancë.

Bashkim Fino – Në vazhdim të kësaj unë nuk e dija dhe tani më thonë që paska shkuar, pasi unë e dija që kjo agjenci vazhdonte të ishte akoma pranë ministres Gjermani, kurse tani kuptoj që AKB-ja ka kaluar të Ministria e Turizmit. Për mua nuk duhet të kalonte, por duhet të mbetej te Ministria e Planifikimit të Territorit, sepse, po të shikoni, unë e kam nxjerr këtu në material vendimin e qeverisë dhe cili është objekti i veprimtarisë dhe funksionimi i AKB-së. Po lexoj disa nga pikat, të cilat nuk duhet t'i mbajnë kolegët dhe nuk kanë të bëjnë fare me turizmin në përgjithësi, por kanë të bëjnë me planifikimin e territorit, megjithatë këta thonë që ka ardhur pranë kësaj ministrie. Në rregull! Në qoftë se kanë ardhur këta bashkë me Kryeministrin, duhet të gjejnë mënyrën krijimit të saj, që unë mendoj se është krijuar në një moment të caktuar për një kohë të pjesshme, për një situatë të caktuar. Mendoj se nuk duhet ta rëndojmë më shumë nenin 8 duke shtuar edhe agjenci të tjera, se unë nuk e kuptoj se ku është ndryshimi midis këtyre dy agjencive që kemi realisht. Unë e kam kuptuar si një agjenci të vetme, që ka qenë te ministria e zonjës Gjermani dhe tani po më thonë se ka ardhur këtu, për mua kjo nuk duhet të vinte sepse duhet të vinte vetëm pjesa e turizmit.

Fatmir Xhafaj – As unë, as ti dhe as dikush tjetër nuk i përcakton se si do të organizohet qeveria. Ne miratojmë ligjin këtu dhe nuk bëjmë organizime qeverie.

Bashkim Fino - Unë po them se kjo agjenci duhet të ngelet se Ministria e Planifikimit të Territorit dhe nuk po them që duhet apo nuk duhet shkrirë. Po të lexosh, fjalja e përgjithshme këtu thotë: AKB-ja ka mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonës bregdetare.

Në detyrat që ka, thotë: AKB-ja, ka si objekt të veprimtarisë së saj këto detyra funksionale: miratimin e politikëve strategjike për menaxhimin e integruar e zonës bregdetare; bashkërendimin e programeve të ndërlidhura me zonën bregdetare; nxitjen e investimeve në zonën bregdetare; dhënien e kontributit në informimin, konsultimin dhe aksesin e publikut të gjerë gjatë hartimit dhe zbatimit të politikave dhe strategjive lidhur me menaxhimin e integruar në zonën bregdetare; marrja pjesë në hartimin e politikave, strategjive kombëtare për menaxhimin e integruar të bregdetit dhe bashkërendimin e punës në zbatimin e tyre; propozimin e ndryshimit për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare; bashkëpunimi me organet përkatëse për projekte dhe aktivitete për mbrojtjen dhe zhvillimin e bregdetit dhe monitorimi për zbatimin e tyre; nxitjen dhe bashkëpunimin me

organet, institucionet, investitorët, aktorët e tjerë ndërkombëtarë apo vendas, përfitimin e tyre për pjesëmarrjen dhe përfshirjen në projekte për zhvillim me rëndësi të menaxhimit të integruar.

Po t'i lexosh, pasi ka edhe shumë të tjera, që nuk dua të harxhoj frymën, kanë të bëjnë me planifikim të territorit dhe me instrumente të tjerë dhe kanë të bëjnë edhe me turizmin, por nuk kanë të bëjnë le themi 100%. Duke lexuar këto kompetenca, që i ka dhënë vendimi i qeverisë kur e ka krijuar, unë mendoj se është një agjenci e përkohshme, në një kohë të caktuar dhe le ta lëmë ashtu siç është me ato kompetenca që ka dhe qeveria po të dojë le t'ia shtojë kompetencat edhe më shumë ose mund edhe të thotë që sot përfundon së ushtruar kjo agjenci dhe mund ta mbyllë. Unë them që AKB-ja nuk duhet të jetë në strukturën e nenit 8.

Petrit Vasili – Një tjetër gjë do të thosha...

Fatmir Xhafaj – Po ju lutem, se ju folët tani!

Petrit Vasili - Kisha për të thënë dy gjëra të fundit!

Fatmir Xhafaj – Dakord!

Petrit Vasili - Prezantuesit e agjencisë në publik kanë bërë edhe një gjë të qartë, të cilën nuk duhet ta harrojmë as ne që jemi këtu ku kanë thënë se: “Një nga objektivat themelore është se agjencia do të ketë një ligj për bregdetin”. Shumë mirë që do të bëhet një ligj i tillë ku do të jetë edhe vetë udhëheqësja e këtij ligji dhe do të ketë një rol të caktuar me ligjin, le ta marrë këtë detyrë, ta zhvillojë, le të bëjë ligjin përkatës, ne këtu jemi dhe do ta mbështesim me vota dhe me opinionet tona. E thashë edhe këtë fakt të fundit për të orientuar se cila do të jetë e ardhmja në aspektin ligjor e punës së tyre.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit! Zoti zëvendësministër keni një koment për ta mbyllur këtë diskutim?

Ervin Mete – Shumë shkurt do flas, zoti kryetar!

Duke qenë se agjencia tashmë është pjesë e Ministrisë së Turizmit, ne e konsiderojmë me vlerë kontributin e saj në menaxhimin e turizmit veçanërisht të zonës bregdetare. I qëndrojmë pozicionit që duhet të jetë pjesë e ligjit përderisa të gjitha institucionet qofshin ato pjesë të instancave shtetërore apo siç kemi përmendur këtu edhe këshillimore janë pjesë e ligjit, i cili është një ligj kuadër “Për turizmin”.

Në këndvështrimin tonë nuk ka çështje ligjore, që lidhen me formatimin e futjes në ligj të agjencisë, megjithatë në qoftë se ju e gjykoni, sigurisht që ne do ta mirëkuptojmë pozicionin e komisionit.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Bashkim Fino – Ka edhe një gjë tjetër. Drafti i projektligjit “Për turizmin”, zoti zëvendësministër, është dërguar për miratim në qeveri në muajin janar 2015 dhe është miratuar me vendimin nr.89 datë 04.02.2015 të Këshillit të Ministrave. Në këtë periudhë sektori i turizmit ishte përfshirë brenda fushës së përgjegjësisë të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit.

Në datën 05.02.2015, me vendim nr.23 të vitit 2015, miraton dekretin e Presidentit, që kalon emërimin e ministres së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, një emër i gjatë thotë Fatmiri me të drejtë, për rrjedhojë edhe sektorin e turizmit. Ndërkohë që, AKB-ja është krijuar me vendim të KM-së nr. 31, datë 22.01.2014, pra është formuar afërsisht para një viti më parë. “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të AKB-së”.

Çfarë dua të them me këtë? Ka kaluar në institucion varësie brenda Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes në muajin prill 2015, pra ka ardhur me vonesë te ju në zbatim të vendimit të KM-së nr. 285, datë 08.04.2015. Pra, është një institucion i ngritur para një viti, ndërkohë që, ligji “Për turizmin” ka filluar të bëhet më parë dhe nuk shkon tani, që të jemi të sinqertë sepse ne i kujtuam këta për hir të së vërtetës, ne e turbulluam ujin, ne u thamë: “Shikoni se ka edhe një agjenci tjetër”, se këta nuk e kishin sjellë në projektligj. Ne ua kujtuam dhe u themi tani se nuk ia vlen të jetë këtu dhe këta tani thonë: “Meqenëse na kujtuat, megjithëse na ka ardhur pak me vonesë ta fusim ne në këtë ligj”.

Ligjet nuk bëhem kështu, ne kemi të drejtë të bëjmë amendamente, kurse ti si qeveri nuk ke të drejtë të bësh amendamente, se ti e ke sjellë projektligjin. Unë kam të drejtë të shtoj nene në një ligj të caktuar, kurse ti si qeveri nuk e ke këtë të drejtë, pasi e kishe atje në seancë plenare, atje ke ta drejtë ta shohësh në seancë plenare dhe ta diskutosh.

Fatmir Xhafaj – Dakord! Vazhdojmë atëherë me nenin 9, ministria përgjegjëse për turizmin.

Bashkim Fino – Si e lamë tani për nenin 8?

Fatmir Xhafaj – Do ta lëmë të hapur dhe do ta votojmë në fund, por me një gjë që është komisioni përgjegjës që do ta ndajë nëse do ta përfshijë apo jo.

Bashkim Fino – Do më falësh pak?

Fatmir Xhafaj – Jo, nuk të fal! Ti je relator dhe pasi ta shikosh, vendos nëse do ta firmosësh ose jo.

Bashkim Fino – Nuk e kam te kjo gjë, se të drejtën e firmës e kam vetë unë dhe nuk më detyron ti, por dua të di mendimin e kolegëve të komisionit, se në qoftë se kolegët kanë ndonjë gjë kundër argumenteve që thashë unë, në rregull! Në qoftë se nuk ka, atëherë do të thotë se qëndron argumenti im dhe kur të shkoj te komisioni përgjegjës për këtë argument të them që nuk duhet të jetë kjo këtu brenda ligjit. Këtë doja unë të vërtetoja.

Fatmir Xhafaj – Unë nuk i kuptoj këto gjërat kështu me dy nënkuptime me thënë të drejtën dhe nuk kam qejf që të flas me nënkuptime.

Bashkim Fino – Ku është nënkuptimi këtu?

Fatmir Xhafaj – Mua nuk më intereson fare ideja, që ua dhamë ne këtyre apo na e dhanë këta neve. Ky diskutim është hapur këtu dhe ministria nuk e ka sjellë në projektin që duhet të sillte. Ministria duhet ta sjellë me shkrim dhe të thotë: “Kërkoj që të përfshihet”, dhe ka të drejtë ministria ta kërkojë këtë gjë.

Zëvendësministri e kërkoi këtë gjë, ju dhatë disa argumente që kjo nuk qëndron. Do t’i shkojë komisionit përgjegjës dhe ai do ta vlerësojë nëse do ta lerë këtu.

(Diskutime pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Më duket se jam i qartë. Ministria duhet ta kërkojë këtë gjë zyrtarisht dhe të japë argumentet e veta dhe ta vendosë ose komisioni përgjegjës, ose seanca si ta çmojnë të arsyeshme se unë nuk e ndaloj dot ministrinë ta sjellë dhe nuk i propozoj që të mos e sjellë se nuk është zgjidhje.

Atëherë vazhdojmë, ministria përgjegjëse për turizmin, neni 9.

Po, zoti Fino!

Bashkim Fino - Jam pak i vrarë shpirtërisht dhe nuk më bëhet të vazhdoj më, se më duket sikur nuk jam i sigurtë edhe në ato që thashë në nenin 8. Unë fola shumë hapur dhe me shumë sinqeritet dhe këta le të bëjnë si të duan, Kuvendi le të votojë si të dojë se unë e kam për detyrë, e kam studiuar dhe jam munduar që si relator të jem serioz dhe kam të drejtë të them

mendimet dhe sugjerimet e mia dhe dua të di vërtet mendimin dhe opinionin e kolegëve të mi të komisionit. Në qoftë se anëtarët e komisionit kanë mendime të kundërta unë jam gati të jap argumente se pse duhet të qëndroj mendimi im, por unë nuk imponoj kurrë mundësinë që ata...

Fatmir Xhafaj – A më lejoni një sekondë të ndërhyjë meqenëse ua dhashë fjalën! Edhe një herë unë isha i qartë dhe jam përsëri i qartë.

Bashkim Fino - Ti nuk ishe i qartë se më vure mua në një pozitë të vështirë dhe më duket sikur nuk isha i singertë.

Fatmir Xhafaj – Jo, unë nuk e kisha në atë sens. Që t’jua sqaroj, për sa kohë që një gjë nuk ka ardhur zyrtarisht nga qeveria nuk hyn këtu në qoftë se nuk vjen si propozim i deputetëve. Ministria mund ta bëjë këtë gjë, qeveria mund ta bëjë këtë gjë edhe në seancë.

Bashkim Fino - Ne mund ta rrëzojmë Fatmir!

Fatmir Xhafaj – Po, dakord!

Bashkim Fino - Ne e kujtuam qeverinë dhe qeveria e solli. Unë jam kundër me këtë gjë dhe po u them kolegëve këtu, a jeni dakord me mendimin tim dhe jo sepse mendimi im është më i miri apo nuk jeni? Në qoftë se jeni, ia transmetojmë komisionit përgjegjës që komisioni ynë Komisioni i Ligjeve me shumicë votash ishte kundër pikës së AKB-së dhe ia çojmë komisionit përgjegjës këtë vendim dhe ata të vendosin si të duan, po të duan le ta fusin dhe në fund e vendos seanca plenare.

Fatmir Xhafaj – Zoti Fino, unë nuk po vë në diskutim një gjë që nuk e kam këtu. E ngritët ju radhën e parë dhe ju e hoqët, se unë nuk e kam në ligj dhe nuk i futem fare këtij diskutimi. Ata, nëse dëshirojnë, mund ta sjellin zyrtarisht dhe të bëhet objekt diskutimi. Sot derisa nuk ka ardhur zyrtarisht unë nuk e bëj objekt diskutimi, prandaj unë jam fare i qartë.

A doni t’ua them prapë? Unë nuk i hyj fare këtij diskutimi, AKB-ja duhet të sjellë një kërkesë nga qeveria ku të thotë: “Për këtë gjë që kam sjellë kam edhe këtë shtesë, një, dy, tre, katër gjëra të tjera”, atëherë shprehem unë.

Bashkim Fino - Dakord! Që të mos bëjmë lodra fjalësh! Një sugjerim për disa ndryshime në draftin e turizmit mua si relator natyrisht pa firmën e ministrit nga ministria më ka ardhur dhe unë kam punuar mbi të dhe kjo është e vërtetë. Përderisa mua më ka ardhur kjo do të thotë se kjo pikë duhet vënë. Nuk më ka ardhur me firmën e ministrit, por më ka ardhur si relator dhe unë e kam parë një gjë të tillë, prandaj e shtrova edhe si çështje.

Fatmir Xhafaj – Unë nuk e dija këtë gjë se nuk e kam

Bashkim Fino - Jo, duhet ta kesh ti çfarë jam unë, thjesht jam fundi i kavallit, siç jam edhe në fund të tavolinës.

Fatmir Xhafaj – Më vjen keq por nuk e kam.

Bashkim Fino - Atëherë zotëri, ju thoni që nuk e pranoni këtë gjë pa ardhur me firmë dhe vulë nga ministri. Të vijë ministri tani dhe t'ia japë kryetarit të komisionit dhe ta shpërndajë dhe unë e kthej përmbys këtë dhe zëre se nuk diskutuam për AKB-në sepse nuk ishte në projektligjin e mëparshëm. Kështu që, jemi në rregull dhe na harxhove kohën kot, ja edhe sinqeriteti im 100%.

Fatmir Xhafaj – Në rregull! Vazhdojmë me nenin 9!

Bashkim Fino - Neni 9 ka vetëm një vërejtje te pika b) ku thotë:

“Ministria e Turizmit harton dhe paraqet për miratim pranë Këshillit Kombëtar të Turizmit planin kombëtar të turizmit”. Unë e quaj të panevojshme këtë pasi plani Kombëtar i Turizmit nuk është instrument planifikimi i territorit, absolutisht dhe duke mos qenë instrument i planifikimit të territorit Plani Kombëtar i Turizmit mund të miratojë diçka tjetër, por jo në Këshillin Kombëtar të Territorit. A e dini se çfarë është Këshilli Kombëtar i Territorit? Plani Kombëtar i Turizmit mund të jetë më i madh nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe unë mendoj që nuk duhet të jetë këtui.

Vazhdojmë te pika c): “Ministria e Turizmit, harton dhe paraqet për miratim pranë Këshillit Kombëtar të Turizmit strategjinë e turizmit dhe planin e veprimt” dhe duhet të shtohet edhe fjalia “dhe përgjigjet për zbatimin e tyre”, pra fjalia duhet të ishte: “Harton dhe paraqet për miratim dhe përgjigjet për zbatimin e tyre”. Këto dy sugjerime kam për pikat që janë të nenit 9.

Vazhdojmë më apo t’i marrim të gjitha me radhë?

Fatmir Xhafaj – Po, ti marrim me radhë!

Bashkim Fino - Pika a) ishte në rregull! A jeni dakord me vërejtjen që kisha për pikën b)? Nuk jeni dakord?

Ervin Mete – Plani Kombëtar sektorial i fushës së turizmit është kompetencë e ministrisë përgjegjëse. Meqenëse zoti Fino, nuk iu referua ligjit “Për planifikimin e territorit”, i cili në nenin 10 “Për përgjegjësitë e ministrive” thotë: Ministrinë janë përgjegjëse për të: a) hartuar dokumente kombëtare planifikimi për sektorët e përgjegjësisë në të cilët ato veprojnë.

Kjo do të thotë se ky është një dokument kombëtar planifikimi në fushën e përgjegjësisë që mbulon kjo ministri dhe është plotësisht në kompetencat e saj edhe në përputhje me ligjet e planifikimit të territorit. Kështu që , nuk jemi dakord me komentet.

Fatmir Xhafaj – Shqetësimi i zotit Fino është që ky plani kombëtar i turizmit është instrument për efekt të planifikimit të territorit që të shkojë në këshillin Kombëtar të territorit apo është pjesë e pelinit të zhvillimit të turizmit? Atëherë, vini një formulim dhe thoni: “Plani i zhvillimit të territorit të turizmit” Po e vutë kështu, atëherë dot shkojë atje.

Ervin Mete - Është terminologjia që është përdorur në ligjin “Për planifikimin e territorit” dhe thotë : Plan kombëtar në fushën e përgjegjësisë.

Fatmir Xhafaj – Përshtate terminologjinë, thotë zoti Fino.

(Diskutime pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Atëherë, ka nevojë që atë sqarohet te dispozitat përkatëse. A jemi dakord? Po, jemi dakord! Vazhdojmë, zoti Fino, me pikën tjetër brenda këtij neni!

Bashkim Fino - Pika c) përcakton kriteret për funksionimin e zyrave të informacionit turistik. Ky term në strukturë nuk është prekur në këtë ligj.

Po të lexosh ligjin, nuk e gjen këtë term, pra “përcakton kriteret për funksionimin” ose plotësojeni, ose hiqeni.

Ervin Mete – Unë kam respekt për komentet e zotit Fino, sepse përgjithësisht janë shumë korrekte, por në këtë rast (nuk e di kush ju ka asistuar) nuk janë korrekte. Zyra e informacionit turistik është pika 52 e nenit 8 “Përkufizimet”, ku thuhet: “Qëllimi parësor i kësaj zyre është t’u sigurojë turistëve informacion”.

Fatmir Xhafaj – Zoti Fino thotë se kjo nuk është e zhvilluar në përmbajtje të ligjit.

Ervin Mete – Është e definuar dhe më pas është e përmendur.

Fatmir Xhafaj – Ku? Te cilat nene është e përmendur? Plotësojeni se çfarë detyrash do të ketë. Jemi dakord që përcakton kriteret për funksionimin e zyrave...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord.

Germa “r” thotë: “Mbështet, nxit dhe ndërgjegjëson sipërmarrjet turistike që ushtrojnë veprimtari turistike si struktura akomoduese, në lidhje me përdorimin me efikasitet të burimeve

natyrore dhe certifikimin eko certifikatë”. Pse është kjo këtu? Për çfarë e keni këtë këtu? Kjo duhet riparë.

Vasilika Hysi – Në lidhje me titullin e nenit 9, ku thuhet: “Ministria përgjegjëse për Turizmin”, mendoj se nuk është qëllimi i këtij neni të përcaktojë se cila është ministria përgjegjëse për Turizmin, por janë një sërë detyrash që ka kjo ministri.

Së dyti, mendoj se ky nen duhet ndarë, sepse disa janë përgjegjësi direkte të ministrisë, pjesa tjetër ka të bëjë me bashkëpunimin me institucionet e tjera, qofshin këto publike ose private.

Fatmir Xhafaj – Janë përgjegjësitë e ministrisë.

Vasilika Hysi – Zoti Xhafaj, 24 detyra në një nen janë shumë, prandaj mendoj që t’i ndajmë në dy-tre nene.

Fatmir Xhafaj – Po si t’i ndajmë në dy-tre nene përgjegjësitë e ministrisë?

Vasilika Hysi – Në radhë të parë titulli nuk mund të vihet “Ministria përgjegjëse për Turizmin”. A biem dakord që titulli nuk korrespondon me përmbajtjen, sepse neni ka të bëjë me detyrat korrekte të ministrisë?

Fatmir Xhafaj – Në rregull, i bëjmë një riformulim titullit “Përgjegjësitë e ministrisë përgjegjëse për Turizmin”.

Vasilika Hysi – Nëse lexojmë të 24 detyrat, një pjesë e tyre kanë të bëjnë me marrëdhëniet me Këshillin Kombëtar të Territorit, planifikimet e turizmit.

Fatmir Xhafaj – Në rregull, sepse janë detyrat e saj.

Vasilika Hysi – Jo, janë detyra që i ka të sajat, një pjesë tjetër janë bashkëpunim ose bashkërendim me institucionet e tjera. Një pjesë e detyrave kanë të bëjnë me pjesën e promovimit. Pra, ky është një nen shumë i gjatë.

Meqenëse po kalojmë te riformulimet, te germa “o” (edhe pse nuk kemi lënë germë të alfabetit pa përdorur) thuhet: “Koordinon zbatimin e politikave të zhvillimit të produktit turistik dhe menaxhimit të destinacionit”. Janë fjali aq të vështira, aq të gjata, të cilat i japin kësaj ministrie një kompetencë gjigante, i japin gjithçka, por nuk del e qartë, po ashtu nuk dalin edhe përgjegjësitë që ka.

Fatmir Xhafaj – Ti mendon se ka nevojë për disa saktësime.

Vasilika Hysi – Në lidhje me pikën 2: “Marrëdhëniet me OJF-të në Shqipëri”, nuk mund ta detyrojë ministria çdo OJF në Shqipëri që të përfshihet në programet e asistencës së ofruar. Pra, kur të themi marrëdhëniet e kësaj ministrie me institucionet e tjera publike, qofshin këto qendrore ose vendore dhe me aktorët e tjerë, që mund të jenë organizata, grupe biznesi, duhet të jemi të kujdesshëm kur të përdorim terminologjinë, nuk mund të përdorim të njëjtin term.

Fatmir Xhafaj – “Që përfshihet në programet e asistencës”, çfarë ka kjo?

Vasilika Hysi – Duhet të njoftojë ministrinë. Ministria bashkërendon të gjitha nismat, aktivitetet etj.

Fatmir Xhafaj – Le ta njoftojë ministrin, pse të mos e bëjë?

Vasilika Hysi – Jam dakord.

Fatmir Xhafaj – Çfarë ka që e njoftoi ministrinë? Cili është problemi?

Vasilika Hysi – Kryetar, kjo është përgjegjësia e ministrisë, duhet të koordinojë.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Neni 10.

Vasilika Hysi – Këtu ngrihen degët territoriale të shërbimit, nuk ka dhëna nëse ngrihen në nivel të ndarjes së re territoriale administrative apo ka edhe një rregull tjetër se ku do të ngrihen degët territoriale. Pra, nuk përcaktohet kriteri mbi të cilin ngrihen.

Së dyti, a do të përcaktohet numri? Në çfarë raporti do të jenë degët territoriale të shërbimit të turizmit, që janë në varësi të Ministrisë përgjegjëse të Turizmit, me organet e qeverisjes vendore?

Ervin Mete – Ne mendojmë se kompetencat janë të qarta dhe mënyra e organizimit në territor dhe në përbërje u mbetet, siç është rregulli, akteve nënligjore, nuk e përcakton ligji se ku do të jenë specifikisht degët territoriale.

Fatmir Xhafaj – Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, unë e bëra këtë pyetje, sepse me këtë ligj krijohen shumë struktura varësie dhe shumë struktura, të cilat marrin shumë kompetenca. Unë, kur lexoj këtë ligj, më del që të gjithë merren me gjithçka dhe të gjithë merren me asgjë. Pra, është më mirë që të përcaktohen dhe të qartësohen kompetencat, çfarë përgjegjësish kanë degët territoriale të shërbimit të turizmit, çfarë do të kenë autoritetet vendore, qeverisja vendore, çfarë do të kenë

komitetet e tjera, çfarë ka Agjencia Kombëtare e Turizmit etj. Kaq shumë struktura që krijohen kanë edhe një faturë financiare. Nëse ne do t'ia lëmë çdo ministri përgjegjës të turizmit që t'i ndryshojë degët territoriale dhe t'i hapë ato sipas dëshirës, pa një kriter të përcaktuar qartë në ligj, mendoj se kjo është një qasje e gabuar. Pra, mënyra e organizimit dhe e funksionimit konkret sesi do të punojë zyra i lihet urdhrin të ministrit përgjegjës, por kriteret bazë mbi të cilët duhen ngritur degët territoriale, të cilat kanë staf, kanë kosto, kanë përgjegjësi duhen përcaktuar në ligj. Nuk mund t'i lëmë ligjet kaq kuadër dhe mund të bëjmë 61 degë territoriale, dikush tjetër bën 10 degë territoriale, dikush tjetër bën në një zonë ku do vetë, tjetri në një zonë tjetër.

Parimet e ngritjes dhe funksionimit të degëve territoriale dhe marrëdhëniet e tyre me ministrinë përgjegjëse duhen përcaktuar në ligj.

Ervin Mete – Sot ekzistojnë këto si struktura, janë të organizuara pranë qarkut.

Fatmir Xhafaj – Janë ngritur që në vitin 2002 për herë të parë.

Ervin Mete – Unë thashë që këto struktura organizohen me akt nënligjor, pra nuk është e thënë që të strukturohen të gjitha në ligj, ekzistojnë aktualisht dhe thjesht po përmenden si pjesë e strukturave institucionale.

Fatmir Xhafaj – Këto janë në bazë qarku?

Ervin Mete – Aktualisht në bazë qarku.

Fatmir Xhafaj – Këto struktura nga varen? Direkt nga ministria.

A kanë drejtoritë e linjës që varen? Në rregull.

Neni 11 “Komiteti këshillimor i sektorit privat të turizmit”.

Zonja Hysi, keni fjalën.

Vasilika Hysi – Edhe kur kemi diskutuar në parim rreth këtij komiteti këshillimor unë kam ngritur disa çështje.

Në radhë të parë, komiteti këshillimor duhet të përcaktohet në ligj se nga kush përbëhet dhe nga sa persona përbëhet.

Së dyti, kam ngritur një shqetësim në lidhje me konfliktin e interesit. Po të lexoni se cilat janë kompetencat e komitetit këshillimor të sektorit privat të turizmit, del se ky komitet këshillimor jep mendime për planifikimin e zonave me përparësi të zhvillimit, jep informacion për ecurinë e sektorit privat dhe i sugjeron ministrisë marrjen e masave për çështjet që kanë të bëjnë me turizmin.

Pyetja që kam bërë herën e parë: a mundet që një shoqatë turizmi, një operator, një OJF që punon në këtë fushë të ketë anëtar dhe ndërkohë të japë mendime, dhe të bie në konflikt interesi, për zonat me përparësi të zhvillimit të turizmit, kompetencë që parashikohet në germën “ç” të këtij neni? E them këtë, sepse duhet të kemi shumë kujdes. Nga mënyra sesi përbëhet komiteti këshillimor, që jepet në pikën 3, i bie që përfaqësuesit që do të marrin pjesë në këtë komitet këshillimor të mos përfitojnë nga projektet që do të bëhen në fushën e turizmit, sepse bie në konflikt interesi, pasi janë ata që japin mendime dhe thonë planifiko këtë zonë, mos planifiko këtë tjetrën me përparësi në zhvillimin e turizmit. Gjithashtu, ato japin mendime për shqyrtimin e akteve nënligjore dhe kemi parasysh që shpesh mund të biesh në konflikt interesi kur shprehesh për ligje për të cilat njëri nga përfaqësuesit operon në fushën përkatëse.

Pra, sa është numri i përfaqësuesve? Në çfarë raporti do të jenë? Si do të përzgjidhen ata? Duhet të parashikojmë që personat e këtij komiteti nuk duhet të jenë në konflikt interesi për çështjet që diskutohen, ata mund të jenë profesorë të universiteteve, mund të jenë specialistë, por që nuk janë kurrësi pjesë e projekteve dhe programeve që mund të bëhen për promovimin e turizmit apo për zhvillimin e zonave me përparësi turizmin.

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni!

Ervin Mete – Në këndvështrimin tonë nuk ka konflikt interesi për aq kohë sa komiteti ka një funksion këshillimor dhe jo vendimmarrës. E vlerësojmë, nisur edhe nga praktikat më të mira ndërkombëtare, por edhe rajonale, që komitete të tilla këshillimore janë të nevojshme të jenë me përfaqësi sa më të gjerë, në mënyrë që të dëgjohet zëri i grupeve të interesit dhe pastaj qartësisht vendimmarrja u përket institucioneve. Për aq kohë sa këto komitete këshillimore nuk janë pjesë e vendimmarrjes, ne nuk shohim që të ketë konflikt interesi, por e shohim si një platformë të institucionalizuar që të marrim në konsideratë komentet, qëndrimet e grupeve të caktuara të interesit, si një mënyrë për ta modernizuar diskutimin me ta.

Fatmir Xhafaj – Ndoshta duhet të përcaktohet më mirë mënyra e anëtarësimit dhe këtë duhet ta riformuloni.

Së dyti, pse këto dy-tri pjesë të këtij komiteti këshillimor duhet të kenë edhe drejtuesit kryesor të turizmit për të qenë pjesë në ministri, sepse ka debat? Saktësojeni.

Ervin Mete - Logjika jonë ka qenë që mund t'i detajonim me akt nënligjor.

Fatmir Xhafaj – Të paktën saktësoni disa kritere të përgjithshme që të jenë orientuese.

Neni 12 “Agjencia Kombëtare e Turizmit”.

A ka ndonjë gjë për të?

Produktin turistik këta e bëjnë, apo e bëni ju? E krijoni ju produktin, këta thjesht bëjnë promovimin.

Neni 13 “Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Turizmit”.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, këtu thuhet që ka një drejtor të Përgjithshëm, por nuk del kush e emëron, kush e liron, sepse nuk mund të thuhet që bëhet në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore. Është praktikë e çdo legjislacioni që, kur krijon një institucion ose një agjenci varësie, qoftë person juridik apo çfarëdolloj forme tjetër, përcakton se kush e propozon emërimin e drejtorit, kush e emëron dhe kush e shkarkon dhe kriteret që duhet të plotësojë një drejtor i Përgjithshëm. Është ligji i parë që shoh se nuk ka fare kriterë.

Fatmir Xhafaj – Çfarë do të thotë “sipas ligjit”, ka ndonjë ligj tjetër?

Ervin Mete – Agjencia Kombëtare e Turizmit është pjesë e trupës së nëpunësve civilë dhe trajtohet sipas atij legjislacioni.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Ky është nëpunës i shërbimit civil? Kriteret do t’i ketë si të gjithë nëpunësit e shërbimit civil.

Ndoshta duhet të vendosim disa kriterë për të qenë drejtor i Përgjithshëm, për shembull duhet të ketë pesë vjet punë.

Neni 14 “Funksionet dhe kompetencat e Agjencisë Kombëtare të Turizmit”.

A keni ndonjë gjë?

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, nga pikëpamja e teknikës legjislative çdo paragraf fillon me AKT-në, kjo nuk shkon. Pra, kur thuhet funksionet dhe kompetencat e agjencisë...

Fatmir Xhafaj – Keni të drejtë.

Për efekt të teknikës legjislative dhe të shkruarit të ligjit, zysha ka të drejtë, këtu që jam plotësisht dakord. Kështu që rregullojeni.

Neni 15 “Inspektorati që mbulon fushën e turizmit”.

Vasilika Hysi – Mendoj që titulli nuk shkon dhe duhet riformuluar.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 16 “Funksionet dhe kompetencat e inspektoratit”.

(Zoti Fino, ndërhyr pa mikrofon.)

Mund ta reflektojmë edhe atje.

Mos janë të njëjta germa “b” dhe “e”?

Ervin Mete – Germa “b” i referohet mjedisit në përgjithësi, pra zonës ku ushtrohet veprimtaria turistike, ndërsa germa “e” u referohet mjediseve të subjekteve. Ndoshta mund të ketë nevojë për një qartësim.

Fatmir Xhafaj – Germa “d” thotë: “Mbledh dhe administron dokumentacionin përkatës, përfshirë edhe dokumentet elektronike, të cilat kanë të bëjnë me objektin e kontrollit”.

Neni 17 “Komisioni i standardizimit të veprimtarive turistike”.

A t’ju bëj një formulim?

“Komisioni i standardizimit të veprimtarive turistike ngrihet me urdhër të ministrit përgjegjës për Turizmin dhe përbëhet nga shtatë anëtarë, si më poshtë: kryetari, i cili është i pavarur dhe me eksperiencë në sektorin e turizmit; ekspertë për menaxhimin e sigurimit të cilësisë; përfaqësues të shoqatave të industrisë së turizmit ose shoqatave të konsumatorëve; ekspertë shëndetësorë dhe sigurie; përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Turizmit”.

A e doni me kriterë?

Ervin Mete – Jo.

Fatmir Xhafaj – Pse?

Ervin Mete – Sepse logjika jonë është që ne këshillohemi me ta, por, kur vjen puna për të vendosur dhe për të aplikuar standarde, kjo është kompetencë shtetërore. Këtu konflikti që përmendi zonja Hysi do të ishte haptazi evident në raport me industrinë. Pra, nëse do të kemi propozimin që industria të jetë pjesë e menaxhimit të IT-së, ku kontrollohet vetvetja...

Fatmir Xhafaj – Prej kujt caktohen këta të Komisionit të Standardizimit? I cakton ministri?

Vendos ca kriterë, që ministrit të mos i teket një mëngjes e të bëjë Komisionin e Standardizimit, duke u bërë favore miqve të vet. Kur t’i kemi kriteret këtu, do t’i miratojmë.

Dakord?

Zoti Fino.

Bashkim Fino – Për çdo ligj që kemi kaluar, ju e mbani mend shumë mirë, kur kemi ngritur komisionet që janë pjesë e ligjit, kemi thënë se si do të jenë. Duhet kompletuar edhe në

këtë rast. Nuk mund ta lëmë pikën 3: “Komisioni i Standardizimit të Veprimtarisë së Turizmit ngrihet me urdhër të ministrit, përgjegjës për turizmin, dhe përbëhet nga 7 anëtarë”.

Kush janë 7 anëtarët? Nga vijnë? Vihet në ligj: një nga ministria filan, një nga...

Nuk jemi keq për të miratuar numrin 7, por për të miratuar cilësinë dhe kushtet që plotësohen. Kështu kemi bërë në çdo ligj.

Nuk po ndërhyjmë: ta bëjnë si të duan, vetëm ta sjellin.

Fatmir Xhafaj – Zoti zëvendësministër, mund ta saktësoni këtë?

Faleminderit!

Neni 18: “Njësitë e qeverisjes vendore, detyrat dhe përgjegjësitë në fushën e turizmit”.

Zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Nëse ju kujtohet, zoti kryetar, gjatë diskutimit në parim, unë pata një shqetësim për pikën “b”, ku thuhet: “Përcjell periodikisht çdo dy muaj inventarin e përmendur”. Nuk besoj të ketë kaq ndryshim të inventarit, që çdo organ i qeverisjes vendore të sjellë kaq shumë informacion në Ministrinë e Turizmit.

E dyta, kam një shqetësim për pikën “ç”: “Të sigurojë infrastrukturën mbështetëse për veprimtarinë e biznesit”. Kur thotë që njësia e qeverisjes vendore të sigurojë infrastrukturën, do të thotë ta ndërtojë, të investojë etj.? Nëse me një ligj të thjeshtë i vëmë detyrime njësive të qeverisjes vendore, kompetencat e të cilave përcaktohen me një ligj të miratuar me shumicë të cilësuar – siç thotë zoti Fino në shtator do të miratohet edhe një ligj tjetër – më duket se raportet e qeverisjes vendore dhe këtyre degëve territoriale të turizmit – nuk e kuptova asnjëherë se çfarë ishin këto – nuk mund të përcaktohen me një ligj që miratohet më një shumicë të thjeshtë. Kompetencat e njësive vendore përcaktohen në ligjin e tyre organik.

Fatmir Xhafaj – Zoti Mete.

Ervin Mete – Në reflektim të komentit të zonjës Hysi, e kemi rishikuar pikën “b” dhe propozojmë që nga dy muaj të bëhet gjashtë muaj.

Për sa u përket kompetencave të qeverisjes vendore, nuk shohim konflikt. Përkundrazi, në kuadër të funksioneve të tyre, edhe me zgjerimin e kompetencave, do të jetë sigurimi i infrastrukturës mbështetëse për veprimtaritë e biznesit të turizmit. Ligji e thekson këtë gjë.

Fatmir Xhafaj – Kemi gjë tjetër? Jo.

Bashkim Fino – Për mua, ky nen është më shumë deklarativ. “Të sigurojë infrastrukturën mbështetëse për veprimtarinë e biznesit”. Ky nen duhet të jetë një çikë më dashamirës me pushtetin vendor, aq më tepër që ky ka një dimension tjetër. Do të vijë edhe një ligj tjetër për decentralizimin.

Vasilika Hysi – Zoti Fino, kujdesin shëndetësor parësor e ofrojnë organet e qeverisjes vendore? U është lënë për detyrë këtu.

(Diskutim pa mikrofon.)

Në fakt, krijohen kaq shumë struktura këtu, prandaj...

Fatmir Xhafaj – E ke fjalën për nenin 19?

Vasilika Hysi – Po.

Këtu krijohen degët territoriale të shërbimit të turizmit, Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit sipas prefekturave, inspektoriate, agjencia kombëtare, degë të tjera...

Fatmir Xhafaj – Do të marrë edhe prefekti, sepse është përfaqësues rajonal i qeverisë.

Vasilika Hysi – Jam dakord, por ky komiteti rajonal...

Fatmir Xhafaj – Prefekti i Vlorës me çfarë do të merret, nëse nuk do të merret me turizmin?

Vasilika Hysi – Kompetenca që ka komiteti rajonal është se siguron një forum diskutimi për probleme të turizmit. Më falni: a po tallemi ne me këtë Komitetin Rajonal të Zhvillimit? Në raport me zyrat territoriale, këto nuk bëjnë asgjë. “Siguron informacion për ministrin”. “Siguron forum të trajtuar”. “Siguron forum bashkëpunimi”. Më duket një hallkë e tepërt.

(Diskutim pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Neni 20, “Parimet e planifikimit të zhvillimit të turizmit”.

Ka gjë për këtë nen? Jo.

Dakord.

Neni 21, “Klasifikimi i burimeve turistike”.

Ka gjë për këtë nen? Jo.

Dakord.

Neni 22, “Regjistri Kombëtar i Burimeve Turistike”.

Ka gjë për këtë nen? Jo.

Dakord.

Neni 23, “Përgjegjësia për administrimin e burimeve turistike”.

Ka gjë për këtë nen? Jo.

Dakord.

Neni 24, “Mbështetja për zhvillimin e turizmit”.

Ka gjë për këtë nen? Jo.

Dakord.

Neni 25, “Përgatitja e planit kombëtar sektorial të turizmit”.

Ka gjë për këtë nen?

Vasilika Hysi – Kam një shqetësim për marrëdhëniet e kësaj ministrie me Ministrinë e Planifikimit të Territorit. Duhet parë ky nen në raport me nenin 9, 20, 25, paragrafi 2, dhe nenin 29. Ky nen gllabëron gjitha kompetencat e ministrive të tjera. Pajtohem me shqetësimin që ngriti zoti Fino, kur diskutuam organet përgjegjëse, neni 8, dhe kompetencat që i kemi lënë Ministrisë përgjegjëse të Turizmit, neni 9.

Nuk del e qartë marrëdhënia që ka kjo ministri me Ministrinë e Planifikimit të Territorit. Nuk arrij të ndaj kompetencat e njëres ministri dhe ministrisë tjetër. I bie që kompetencat e Ministrisë së Planifikimit të Territorit të përfshihen në kompetencat e Ministrisë së Ekonomisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes.

(Diskutim pa mikrofon.)

A të bëj një pyetje për zëvendësministrin?

Nëse kjo është ministria që do të përgatisë planin kombëtar sektorial të turizmit...

(Diskutim pa mikrofon.)

Zoti kryetar, në çdo ligj kemi përcaktuar një nen ku përcaktohen marrëdhëniet e bashkëpunimit...

(Diskutim pa mikrofon.)

Ervin Mete – Parashikimi është në linjë me ligjin “Për planifikimin e territorit”, i cili në nenin 10 përcakton që ministrinë e tjera kanë kompetenca për të hartuar planet kombëtare për sektorët e përgjegjësive të tyre: për të propozuar rregullore ndërtimi, për të garantuar cilësi, për të marrë masa për zbatimin, për të inspektuar, për të bashkëpunuar me autoritetet e planifikimit të çdo niveli, sipas ligjit për të raportuar. Pra, logjika është që të energjia e bën energjia, të

transportet e bëjnë transportet, te turizmi ministria përgjegjëse. Kjo bëhet në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit dhe i propozohet KKT-së.

Bashkim Fino – Është instrument ekzekutiv, siç është shkruar këtu? Domethënë, Ministria e Turizmit do të na bëjë një plan kombëtar sektorial të turizmit, në të gjithë territorin, në përputhje me parashikimet e ligjit “Për planifikimin e territorit”, po a është kjo ekzekutive?

Ervin Mete – Në momentin që miratohet nga KKT-ja, ajo përbën master-plan dhe në bazën e tij bëhet zhvillimi i zonës.

(Diskutim pa mikrofon.)

Vasilika Hysi – Nëse kemi një Ministri të Planifikimit të Territorit, që ka për detyrë të planifikojë të gjithë territorin, ky plan kombëtar sektorial i turizmit, a nuk ka nevojë të ketë një oponencë?

Të ketë një koordinim ndërmjet këtyre dy ministrive. Këtë kërkoi Sonja, që të ketë një parashikim në ligj.

Ju thoni që Ministria përgjegjëse e Turizmit, në cilësinë e Autoritetit Kombëtar të Planifikimit të Territorit, përgatit planin kombëtar.

(Diskutim pa mikrofon.)

Dakord. Do të ketë një paragraf, ku të përcaktohen këto marrëdhënie, para se të shkojnë te AKPT-ja?

Fatmir Xhafaj – Ata kanë një ligj më vete, që rregullon veprimtarinë e tyre. Kur shkon Kryeministri dhe u thotë: “Cili është mendimi teknik i sekretariatit të KKT-së, që është pranë ministrisë?”, i thotë: “Nuk mund ta ketë këtu, sepse kjo zonë është për x gjë”.

Bashkim Fino – Sa herë miratohet kjo? Miratohet një herë, apo mund të miratohet herë pas here?

Fatmir Xhafaj – Zoti Mete.

Ervin Mete – Ajo që po diskutojmë, është e rregulluar e gjitha në ligjin “Për planifikimin e territorit”.

Në përgjigje të zotit Fino: neni 25, të “Miratimi i dokumenteve të planifikimit”, thotë: “Autoriteti përgjegjës i planifikimit i miraton ose i kthen për rishqyrtim”. Neni 26 (“Rishikimi i planeve”): “Planet e përgjithshme janë objekt ndryshimi, kur është e nevojshme”.

Neni 17 thotë: “Planet kombëtare sektoriale hartohen nga ministrinë, me qëllim zhvillimi strategjik të një apo më shumë sektorëve të ndryshëm, sipas fushës së kompetencës”. Pra, siguria kombëtare, energjia, industria, transporti, infrastruktura, turizmi, zonat ekonomike etj.

Ligji “Për planifikimin e territorit” e ka të rregulluar se si miratohen planet nga dy nivele: niveli qendror, që është KKT-ja, ose niveli lokal, është bashkia.

E theksoj: është miratuar kur ka qenë pjesë e ministrisë tjetër.

Bashkim Fino – Unë bëra një pyetje tjetër, që ka të bëjë me Ministrinë e Turizmit, e cila paraqet planet e zhvillimit kombëtar të sektorit të turizmit. Unë mendoj se nuk mund t’i kërkojmë këtij plani që për 10 vjet në këtë zonë të bëjmë një resort turistik, ndërsa pas 10 vjetëve të mund ta prishim atë dhe të bëjmë diçka tjetër. Nuk më duket korrekte.

Mua më duhet një plan i përgjithshëm kombëtar (që mund të vonohet me vite) nga Ministria e Turizmit, në bashkëpunim me planifikimin e territorit dhe KKT-në, për ta miratuar përfundimisht për të gjithë Shqipërinë. Turizëm nuk është vetëm deti. Turizëm janë Alpet, liqenet e me radhë. Në momentin që miratohet, nuk mund të ngremë idenë se pas 10-15 vjetësh mund ta prishim këtë dhe të bëjmë një gjë tjetër.

A do të ketë një plan strategjik afatgjatë për zona të caktuara? Kjo që ideja e pyetjes. Nuk kërkoja që të më kthehej përgjigje me nenin 24 të planifikimit të territorit.

Fatmir Xhafaj – Zoti Mete.

Ervin Mete – Me miratimin e ligjit, hapi i bërë që bëjmë është hartimi i këtij plani. Puna ka nisur në pjesën jugore, ku po evidentohen edhe pasuritë shtetërore dhe private, sipas rastit, si dhe po punohet me një grup të gjerë pune, në bashkëpunim me AKPT-në. Logjika është që bashkë me to të hartohet ky plan si hap i parë pas këtij ligji, pastaj të orientohet zhvillim.

Faleminderit!

Vasilika Hysi - Më fal, zoti Mete!

Po të lexoni nenin 25 dhe pikën 1 të nenit 29, në nenin 25 i lihet kësaj ministrie të përgatisë planin kombëtar sektorial të turizmit.

Në nenin 29 rendis një sërë ministrish, të cilat janë përgjegjëse për të përgatitur planin e zhvillimit të veprimit për çdo zonë me përparësi të zhvillimit të turizmit ku fusni ministrinë, dhe nuk merret vesh se cilat janë ministrinë. Organet publike, organet e qeverisjes vendore, grupet e interesit.

Pra, po të shikoni, ka një mospërputhje midis planit kombëtar sektorial të turizmit, që ia lini ministrisë përgjegjëse të Turizmit dhe më pas te caktimi i planit të zonave me përparësi të zhvillimit të turizmit, që padyshim janë pjesë e planit kombëtar sektorial të turizmit, ia lini një sërë ministrive që emër nuk kanë, mbiemër nuk kanë. Jua lini të gjithëve dhe askujt.

Ervin Mete - Referimi është bërë te ligji i planifikimit të territorit dhe sipas rregullimeve të atij ligji ku ka nevojë për konsultë do të konsultohet.

Vasilika Hysi – Nëse lexojmë përmbajtjen e nenit 29, nuk është lënë konsultë, por është detyrim, pasi thuhet që ministria përgjegjëse për Turizmin përgatit planin e zhvillimit të veprimit për çdo zonë me përparësi në bashkëpunim me ministritë. Me cilat ministri? Me organet publike. Me cilat organe publike? Me organet e qeverisjes vendore dakord, si dhe me grupet e interesit, dhe e paraqet për miratim, sipas parashikimit të ligjit për planifikim dhe zhvillimin e territorit, mbështetur dokumentet e planifikimit kombëtar e vendor. Prandaj jua thashë se te përmbajtja e nenit 25 ka nevojë të qartësohet dhe të jetë në përputhje edhe me nenin 9 edhe me nenin 20 që sapo kaluam edhe me nenin 29 që sapo ju citova. Ndoshta duhet të ketë një paragraf të dytë te neni 25, por duhet thënë diçka, duhet rregulluar. Si apo kur, unë nuk jam specialiste e kësaj fushe, por shoh që ligji ka një përzgjedhje përgjegjësish, kompetencash.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Neni 27. “Caktimi i zonave me përparësi zhvillimin e turizmit”. E kaluam atë.

Neni 28.

Bashkim Fino - ... në përputhje me planin e përgjithshëm kombëtar dhe planin kombëtar sektorial të turizmit. Kaq fjali e gjatë sa që të lodh. Unë po them mbi bazën e të cilave kriteret do ta krijojë, se ai mund të thotë se kjo do të quhet zonë turistike.

Fatmir Xhafaj – Ka një dokument që orienton?

Bashkim Fino – Po flas në gjuhën popullore, sa herë që të shkojë te KKRT-ja.

Ervin Mete – Zonat me përparësi zhvillimin e turizmit është vetëm një nga konceptet që parashikon ligji i planifikimit të territorit dhe siç miratohen zona të tjera do të trajtohet edhe në këtë rast. E thashë, mënyra se si funksionon Këshilli Kombëtar i Territorit, kërkesat, miratimi i planeve sektoriale dhe i përgjithshëm rregullohen me atë ligj. Sigurisht që do të bëhet në bazë të kriterëve dhe asaj që është miratuar për planin sektorial dhe kombëtar. Pasi miratohet plani sektorial dhe kombëtar miratohet dhe zona në funksion të këtij plani.

Bashkim Fino - ... por këta nuk e njohin ligjin. Kanë nenin 29. Ky nen këtë thotë: plani i zonave me përparësi zhvillim-turizmin. Këto janë pikat. Këta duhet ta lidhin me nenin 27. Unë e provokova në rastin konkret. Ky në vend që të më thoshte që e ke në nenin 29, ke mbi 100 kriteret atje, më lidh me ligjin e planifikimit të territorit. Jo more zotëri! Thuaj që neni 27 është i lidhur më poshtë sipas dhe kohës. Këto janë ato pikat. Kaq.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Provokimi doli me sukses.

Neni 27 kaloi me sukses.

Neni 28. “Mbrotjtja, ruajtja e përdorimit dhe zhvillimi i burimeve natyrore turistike”.

Keni ndonjë gjë për këtë? Jo.

Neni 29. “Plani i zonave me përparësi zhvillimin e turizmit”.

Jeni dakord?

Vasilika Hysi – Unë nuk e kuptoj këtë pikën 2. Kam një pyetje. Mund të zhvillohen bizneset private, në hotele, në mjedise, në prona shtetërore? Thoni që zhvillimi dhe operimi i një sipërmarrjeje turistike, hotel komplet turistik, mund të bëhet dhe në pronë shtetërore, me kusht që këto struktura, ndërtimet thotë të mos dëmtohen. A ka ndonjë rregull si rregullohet ky problemi që në pronë shtetërore unë të bëj biznes privat?

Fatmir Xhafaj - E kanë parashikuar. Neni 29 dakord.

Neni 30. “Mbështetja financiare për projektet në fushën e turizmit”.

Vasilika Hysi – Te neni 30 unë kam disa shqetësime. E para lidhet me pikën 3, ku thuhet: “Ministria përgjegjëse për turizmin nga fondi buxhetor i miratuar çdo vit financon projekte edukimi, promovimi dhe studimi, apo modelesh, produkte turistike” etj. Do të ketë ndonjë kriter të këtyre? Sa përqind të fondit, se mund t’i teket ta bëjë të gjithë fondin reklama dhe nuk investon në infrastrukturë.

Fatmir Xhafaj - I ke në zërat e buxhetit. I miraton këtu në parlament zërat e buxhetit. Dhe thotë kaq lekë për promovim.

Vasilika Hysi - Kjo u jepet personave juridikë dhe fizikë. Pra, nuk e administron vetë ministria, por u jepet si donacion personave fizikë dhe juridikë. Pse e bëra këtë pyetje.

Fatmir Xhafaj – Vendas dhe të huaj. Do të bëjnë konkurse.

Vasilika Hysi – Jo. Në pikën 4 thuhet që ky fond nuk i nënshtrohet legjislacionit për prokurimin publik. Pra, ministri mund ta përdorë sipas dëshirës së tij. Unë e pyeta se sa përqind e

fondit, 30, 40, 50 milionë euro do të bëhet pa prokurim publik? Pyetja që bëra për pikën 3 lidhur me fondin limit për të cilin...

Fatmir Xhafaj – E ke te pika 5. Që arrijnë mbi 50% të fondit vjetor të parashikuar miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Vasilika Hysi – Kalo pak te pika 6. Miratimi i projekteve turistike bëhet nga ministri përgjegjës, me propozim të komisionit të përzgjedhjes së projekteve përbërë nga 7 anëtarë, 5 nëpunës të lartë të strukturave dhe 2 përfaqësues nga shoqata e sektorit të turizmit. Pyetjen e kam për pikën “b”, për këta dy përfaqësuesit nga shoqatat e sektorit të turizmit. U lejohet këtyre të marrin nga ky fond, duke qenë se janë pjesë e komisionit të përzgjedhjes së projekteve. A mund të thuhet këtu që të shmanget konflikti i interesit? Dhe meqenëse ju thoni se kjo pika, ku projektet të cilat kërkojnë një financim, që janë mbi 50% të fondit, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, kjo nuk do të thotë që në rast se miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave nuk u nënshtrohen ligjeve të prokurimit publik. Nuk e di konkretisht. Ndoshta mund të na ndihmojë. A parashikon ligji i prokurimit publik përjashtime të tilla?

Fatmir Xhafaj - Po, parashikon, por nuk parashikon këto të turizmit.

Në ligjin “Për prokurimin publik” përcaktohen përjashtime nga procedurat e prokurimit. Por për turizmin nuk është përjashtuar. Ky ligj bie në kundërshtim me atë. Duhet rregulluar dhe atje.

Bashkim Fino – Këto dy çështje kam unë, që ngriti zonja Hysi, por unë i kam komplet ndryshe. Në fakt kjo e prokurimit duhet të jetë në ligjin e prokurimit, çështja e promovimit të turizmit, aq më tepër që çdo vit ka promovim turizmi dhe çdo vit ministrisë i ha një kohë të gjatë ajo procedura e famshme për të bërë promovim. Ndërkohë, televizionet e ndryshme private po bëjnë promovimin e turizmit dhe po e bëjnë shumë mirë. Shihni me kujdes Top Channel apo të tjera. Para se të fillojnë lajmet, thotë ai promovim nga Top Channel për turizmin shqiptar dhe bravo i qoftë që e bëjnë çdo verë! Ne nuk kemi parë akoma promovimin që bën vetë qeveria shqiptare, agjencia apo Ministria e Turizmit. Unë mendoj se duhet të ndërhyjmë në ligjin e prokurimit ku atje të themi që dhe për promovimin e turizmit shqiptar normalisht duhet të jetë kompetencë e qeverisë, e ministrisë që ta bëjnë në momente të caktuara. Mund ta bëjnë dhe në tetor, mund ta bëjnë në një moment tjetër të rëndësishëm dhe duhet të ndërhyjë atje.

Fatmir Xhafaj – Mund ta bëjnë në një moment që ka një sulm ndaj produktit turistik shqiptar se ka një evazion të një vendi fqinj.

Bashkim Fino – Ti mund të përfitosh shumë gjëra, por sot ke krizë në Greqi. Ti sot po të bësh promovim, mund të kesh mundësinë që të rritësh të ardhurat nga turizmi shqiptar. Ti sot nuk ke. Sot e nxjerr vetëm në Top Channel dhe në ndonjë televizion tjetër që ata e dinë për qejf atë reklamë, ndërkohë që nga shteti nuk ka asnjë reklamë në këto momente. Pra, unë mendoj që pika 4 duhet të rregullohet bashkë me këtë ligj, të lidhin një amendament te ligji i prokurimeve ku të shënohet atje që përjashtohet për turizmin dhe të mos merremi me këtë punë. Se po e bëme me përjashtime ligjesh të caktuara është më keq. E para.

E dyta, po ta lexosh me kujdes pikën 6, çfarë thotë pika 6? Miratimi i projekteve turistike. Pra, ministri miraton projekte turistike, bërë nga ministri përgjegjës për Turizmin me propozim të komisionit. Pra, miraton projekte turistike që do të financojë, do t'i japë mundësinë. Pse duhet të krijojmë ne komision, 5 nga ministria, se kjo është punë e përditshme e ministrisë, dhe 2 nga shoqatat dhe nuk kemi pse e themi në ligj? Unë jam i një kategorie tjetër. Miraton projekte turistike nga ministri përgjegjës i turizmit me propozim të Agjencisë së Turizmit, që e njeh shumë mirë këtë situatë. Dhe thotë unë të propozoj ministër. Ministri e ka në dorë. Nëse do, e shkruan, i firmos, në mos nuk i firmos që ti të miratosh projekte turistike një, dy tre, katër, pesë, i merr ministri, i lexon, i shikon, i miraton në qoftë se ka fonde. Çdo me thënë kjo? Bëjmë 4-5 pika të tjera, jo ngrihet një komision, 5 nga ministria, 2 nga ajo kot më kot. Mua më duket artificë e jashtëzakonshme kjo që po shkruajmë në ligj. Kjo është si formë rregulloreje. Për mua kjo do shkruar shumë thjeshtë; miraton projekte turistike nga ministri i Turizmit me propozim të Agjencisë Turistike dhe e gjykon si të dojë ministri sa herë të dojë, kur të dojë etj. Po këta 5 nëpunës çfarë janë? A janë punonjësit e ministrisë? A do ta bëjnë atë punë këta të agjencisë? Do ta bëjnë këtë punë normalisht. Pse do e shkruajmë në ligj? Këto dy vërejtje kam për këtë nen.

(Zoti Fino flet pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Ka qenë kjo në ligjin e mëparshëm? Pse e keni hequr atë? Fondi i zhvillimit të turizmit krijohet nga kjo dhe ajo, si dhe e administron ministri. Është dukur si risi ajo.

Ervin Mete – Ka pasur një përplasje me Ministrinë e Financave, e cila fond specifik jashtë buxhetor, siç ishte konceptuar ky, e sheh shumë të vështirë për ta administruar dhe nuk

është vënë asnjëherë në jetë, sepse me fonde speciale që quhen ata është vetëm fondi i sigurimeve e kështu me radhë. Kështu që është konceptuar ky model i propozuar dhe është sipas atij që është sot në ligjin “Për kulturën”, të cilët i trajtojnë në të njëjtin format siç është propozuar projektet kulturore. Megjithatë për thjeshtësi ne jemi dakord me propozimin e zotit Fino.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Ervin Mete – Ju lutem, vetëm të qartësojmë propozimin e parë.

Fatmir Xhafaj – Ky nuk mund të pranohet që nuk i nënshtrohet legjislacionit të prokurimit publik sa kohë që ke një ligj **kuadër**. Dhe ky nuk prevalon mbi ligjin **kuotë**. Ndryshoni ligjin e prokurimeve publike dhe jemi dakord. Ne do ta vendosim sipas legjislacionit të prokurimit publik.

Ervin Mete – Çështja është që jo vetëm promovimi në televizionet shqiptare...

Fatmir Xhafaj – Ky komision ka dhe historinë e vet. Ka pasur raste të tilla të ngjashme dhe nuk i ka pranuar. Dhe ju, me sa di unë, jeni në dijeni të këtij fakti. Dhe i ka thënë referoju ligjit kuadër, për shkak se ai është një ligj që prevalon, për shkak se vendosen rregulla që janë rregulla bazë mbi të cilat operojnë të gjithë aktorët. Kështu që ne nuk mund të bëjmë një përjashtim në rastin e turizmit. Ky është qëndrimi që ne kemi mbajtur dhe besoj se kemi bërë mirë, sepse ndryshe pastaj secili që vjen këtu do të kërkonte përjashtime, kurse e parë kjo te ligji kuadër është më në harmoni. Nëse ligjvënësi aty e merr në konsideratë mund ta bëjë këtë përjashtim, siç ka bërë përjashtime të tjera. Në parim dhe unë jam që të ketë përjashtim, por te ligji kuadër, këtë them. E mbështes idenë tuaj që të ketë përjashtim. Pse duhet të ketë përjashtim? Duhet të ketë përjashtim për shkak se periudhat turistike janë periudha afatshkurtra. Dhe nevojat që mund të lindin janë nga më të ndryshmet. Është si kjo që thotë zoti Fino, ose do të promovosh një produkt turistik, apo do të krijosh një epërsi, ose konkurrentët e tu në treg kanë dalë me një produkt të ri. Ti ke nevojë që ta konkurrosh produktin që të mos humbasësh sezonin. Nuk do të rrish të presësh të bësh tenderin. Jam dakord. Janë arsye të përligjura, por forma e zgjedhur nuk është e gjetur.

Ervin Mete – Jo vetëm kaq, jo vetëm në televizionet e brendshme, por problem shumë i madh bëhet tek televizionet jashtë.

Fatmir Xhafaj - Jam shumë dakord, por gjeni formën e përshtatshme dhe keni të drejtë. Unë do ta votoj pro po erdhi ky propozim.

(Zonja Hysi flet pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – *(Zoti Xhafaj flet pa mikrofon.)*

Po, dakord me nenin 30 bashkë me sugjerimet dhe vërejtjet që u bënë.

Neni 31.

Vasilika Hysi – Është kjo që tha zoti Fino. Nëse ne do t’ia lëmë agjencisë dhe nuk do të jetë komisioni i përzgjedhjes së projekteve i bie dhe neni 31 që flet për kompetencat dhe komisionit përzgjedhës së projekteve.

Fatmir Xhafaj – Të shkojë në të njëjtën linjë me 30.

Neni 32. “Format e partneritetit”.

Jeni dakord.

Neni 33. “Pasuritë e paluajtshme shtetërore në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit”.

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Pasuritë e paluajtshme në pronësi të shtetit apo të njësive të qeverisjes vendore, që ndodhen në zonat me zhvillim përparësi turizmin, me vendim të Këshillit të Ministrave brenda 2 muajve nga miratimi i zonës i kalojnë në administrim ministrisë përgjegjëse. Jam dakord.

E para, neni 113 i Kushtetutës dhe ligji nr.8652 “Për pushtetin vendor” po të shikosh nenet 8, 20, pikën 2, përcaktojnë të drejtën e pronësisë së një prej të drejtave më themelore që ka pushteti vendor. Do ia lë pushteti vendor këtë gjë, me një ditë të thjeshtë, ndërkohë që ne kemi miratuar një kushtetutë dhe një ligj nr.8652 me 3/5-at? Se në koncept nuk ka ndonjë gjë të keqe që është zonë me përparësi zhvillim turizmi dhe automatikisht dhe pushteti lokal duhet ta lërojë ose duhet t’i japë ministrisë përkatëse për ta zgjidhur e me radhë. Por, për ta marrë kështu si pronë nga ana juridike ka një problem, ju e dini më mirë këtë. Në ligjin e pushtetit lokal dhe në Kushtetutë ai e ka në inventarin e pushtetit lokal. Nuk ta jap thotë. Çfarë i bën? Ti nuk e detyron dot me këtë ligj.

Fatmir Xhafaj – Po.

Vasilika Hysi – Gjithashtu, zoti kryetar, mua më shqetëson përmbajtja e nenit 2, ku thuhet: “Këshilli i Ministrave rast pas rasti miraton me vendim të veçantë transferimin në favor të shtetit të pasurive të paluajtshme në pronësi të njësive të qeverisjes vendore”. Mënyra se si

është formuluar rast pas rasti, që mund t'ia marrësh qeverisjes vendore këtë, është cenim i asaj të drejte, autonomisë. Ky nën është problematik.

Nga ana tjetër mua më shqetëson dhe raporti i këtij nëni, i pasurive të paluajtshme që mund të jenë në pronësi të njërive të qeverisjes vendore, por ndërkohë mund ta kenë pronarë që kanë fituar gjyqet në Gjykatën e Strasburgut dhe janë në proces të kthimit, të kompensimit ose në fazën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, përfshirë dhe vendimet e Strasburgut.

Ervin Mete – Logjika është që në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, të cilat siç thamë përcaktohen nga KKT-ja pasi është miratuar plani kombëtar dhe sektorial dhe që lejet, administrimi, duke qenë se të gjitha konsiderohen leje zhvillimore komplekse, bëhet me propozues ministrinë dhe nga KKT-ja, pra nuk kanë pushtetet vendore kompetenca zhvillimi në këto zona me përparësi turizmin, të kalojë dhe administrimi i pronës për të ruajtur standardet, njëtrajtësinë në ministrinë përgjegjëse të turizmit. Legjislacioni i transferimit të pronave, që ka ndodhur prej vitit 2001 e këtej, lejon transferimin apo marrjen mbrapsht me vendim të Këshillit të Ministrave të pronave që mund t'u kenë kaluar në administrim të pushtetit vendor. E para.

Dhe e dyta, edhe vetë ligji i planifikimit të territorit parashikon mundësinë e kalimit në favor të pushtetit qendror, të pronave të pushtetit vendor. Më saktë në nenin 35 të ligjit “Për planifikimin” thuhet se “Këshilli i Ministrave ka të drejtë të vendosë transferimin e pasurisë së paluajtshme publike pronë e njësive të qeverisjes vendore në favor të shtetit për realizimin e investimeve...”. Në legjislacionin që kemi parimisht ekziston mundësia të kalojmë nga pushteti vendor në atë qendror. Logjika këtu është se për ato që janë zona me përparësi zhvillimin e turizmit edhe sikur të ishin nën administrimin e pushtetit vendor, të drejtën për t'i zhvilluar do ta kishte përsëri ministria dhe KKT-ja, sepse janë leje zhvillimore komplekse, të unifikohen dhe të kalojnë në administrimin e ministrisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Bashkim Fino - Jam dakord me logjikën që zonat me përparësi turizmin duhet të kenë zhvillim dhe duhet t'u japim zhvillim. T'ia japim investitorit, të mos i krijojmë probleme. Të takojë 100 pronarë, të takojë edhe përfaqësuesit e pushtetit lokal, por t'ia japim atë 1 euro dhe t'i themi: merre dhe zhvilloje, bëj investimin! Bravo të qoftë! Kështu mund të zhvillohet Shqipëria, por në rastin konkret, një takim bëri sot Kryeministri dhe nuk shkuan kryetarët e

djathtë të bashkive. Ata nesër duhet të bashkëpunojnë me Kryeministrin dhe me qeverinë, sepse këtej nga ne do ta marrin buxhetin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj - Të shikojmë se si ta riformulojmë, sepse duhet të gjendet një zgjidhje. Çfarë do të bëjnë nëse janë të copëzuara?

Ervin Mete – Megjithëse nuk është zoti Fino, do të thosha se nuk i lë kompetencë këshillit bashkiak. Vendos Këshilli i Ministrave që ashtu siç ua ka transferuar...

Fatmir Xhafaj - I ka në administrim apo në pronësi?

Ervin Mete - Ka dy forma.

Fatmir Xhafaj - Nëse është në administrim, logjika është ajo që thoni ju, por për ato që janë në pronësi, më vjen keq.

Ervin Mete - Duke iu referuar ligjit “Për planifikimin e territorit”...

Fatmir Xhafaj – Ai nuk jep dhe merr pronësi.

Ervin Mete – E merr pronësinë.

Fatmir Xhafaj - E para, kjo është një normë kushtetuese.

E dyta, ligji “ Për organet e qeverisjes vendore” është me tre të pestat. E lëmë ta shikojmë me qetësi dhe t’i shikojmë të gjitha bashkë, si paketë.

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi - Kam një pyetje për parashikimin që bëhet në nenin 34. Lidhur me paragrafin e dytë dhe të tretë, nga dallon kohëvënia në dispozicion që thuhet deri në 99 vjet, do të jepet me një euro, pa euro, me qira? Pika 3, ku thuhet: “Vënia në dispozicion pasurive të paluajtshme shtetërore mund të bëhet edhe...

Fatmir Xhafaj - Dhënia në dispozicion apo në përdorim?

Vasilika Hysi - Nuk po e marr vesh.

Fatmir Xhafaj – Në “dispozicion” nuk është term juridik.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, këtu thuhet: “vënia në dispozicion nëpërmjet kontratës simbolike një euro”. Pra, e shet, e jep me një euro, dhe kur e vë në dispozicion deri në 99 vjet, e jep në përdorim? Nuk del e qartë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj - Të rregullojmë termin. Atyre mund t'ua japësh në përdorim, t'u thuash merrini magazinat e ushtrisë dhe do t'i bëni resort turistik, por duhet një rregullim që ta përshtatim me nenin 33. Në parim jam dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Me qira, emfiteozën, koncesion ato format që ka ligji.

Ervin Mete - Koncepti i vënies në dispozicion është përmendur te ligji “ Për investimet strategjike” dhe përpiqet të kapë diapazonin më të gjerë të mundshëm që nga dhënia me qira, pa qira, mund të jetë huapërdorje, emfiteozë dhe kështu me radhë deri te kalimi i së drejtës së pronësisë.

Fatmir Xhafaj - E ke pranuar te ligji “ Për investimet strategjike”.

Ervin Mete - Pika 5 thotë që mund të kalojë edhe transferimi i pronësisë duke e kushtëzuar me realizimin e plotë të investimit siç e kërkojnë normalisht, pra standard.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj - Ta rishikojmë këtë me qëllim që të përputhet me Kodin Civil.

Neni 35. “Marrëveshja me investitorin”.

Vasilika Hysi – Te pika 5, është hera e parë që shoh në ligj që thuhet “rast pas rasti”. “Transferimi i së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme nga shteti te privati, rast pas rasti”.

Ervin Mete – Edhe në nenin e mëparshëm “rast pas rasti” ka të bëjë me marrjen e vendimeve specifike. Këshilli i Ministrave të shprehet specifikisht me një vendim të posaçëm për pronën në fjalë ose për transferimin e pronës...

Fatmir Xhafaj - Mund të mos e kishin vendosur fare këtë shprehje dhe ti nuk do të thoshe asgjë. Këshilli i Ministrave mund të vendosë transferimin e së drejtës.

Ervin Mete – Për sqarim, e kemi marrë koment nga ZRPP-ja, e cila thotë se unë kur ta regjistroj, e dua të mos jetë me një listë me, por ta kem të veçantë se çfarë ka kaluar.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

“Marrëveshja me investitorin”. Marrëveshjet e zhvillimit janë në rregull.

Neni 36. “Portet turistike”. Jemi dakord.

Neni 37. “Të drejtat dhe detyrat e investitorit në zonat me përparësi turizmin”.

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi - Kam një pyetje lidhur me pikën 2 kur thoni se investitori është i lirë në format e administrimit dhe të ofrimit të produkteve turistike, përfshirë *timeshare*-in. Nuk ka ndonjë kontroll nga këto agjencitë e zhvillimit të turizmit? Kur thua se është i lirë në format e administrimit, e lë jashtë çdo kontrolli. Ka ndonjë gjë, për shembull në përputhje me rregullat, me kriteret e përcaktuara me aktet ligjore, nënligjore? Pasi e keni lënë të lirë fare.

Ervin Mete – Kjo është më shumë deklarative për të thënë se për aq kohë sa do të jetë strukturë turistike dhe menaxhohet si e tillë, operatori është i lirë në formën e menaxhimit dhe është theksuar *timeshare*-i që është një koncept novator, që ai blen në një format pronësie. Mund të ketë, që bëhen tashmë në bazë të rrjeteve ndërkombëtare e kështu me radhë, pra formate novatore të panjohura nga ne. Ai është i lirë në administrim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Kontratë është kjo apo marrëveshje me ministrinë? Është marrëveshje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ka disa forma të marrëveshjeve, është një koncept i njohur juridik.

Ka ndonjë gjë tjetër? Jemi dakord me vërejtjet.

Vasilika Hysi - Kam një pyetje, ju i jepni të drejtë që investitori të nënkontraktojë në ndërtimin e strukturave të treta, por ai mund t'u transferojë edhe pronësinë strukturave të veçanta akomoduese tek të tretët dhe tek investitori, ndërkohë që investitori ka bërë një marrëveshje në zonat me përparësi të zhvillimit të turizmit, ku ka një sërë angazhimesh reciproke, i japim pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, pronë të shtetit dhe të qeverisjes vendore dhe në fund fare në një pikë 4 i themi se ai mund ta transferojë pronësinë e strukturave të veçanta të tij, tek të tretët. Kjo bëhet vetëm me miratim të ministrit përgjegjës. A nuk ekziston rreziku që unë të bëj një marrëveshje si investitor strategjik? Të marr edhe prona të shtetit edhe të qeverisjes vendore dhe pastaj të bëj një marrëveshje dhe t'ia jap dikujt tjetër vetëm me firmën e ministrit, ndërkohë që pronat i kam marrë me vendim të Këshillit të Ministrave?

Fatmir Xhafaj – Rëndësi ka që ai do të ruajë objektin e investimit dhe nuk do të cenojë qëllimin e investimit. Çfarë rëndësie ka se është a-ja, b-ja ushtruese e së drejtës në atë rast. Çfarë do ti?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është objekti im, e kam pjesë të marrëveshjes dhe po ta kaloj. Atë që kam marrë në pronësi do të kaloj unë. Atë që nuk e kam në përdorim nuk e kaloj dot në pronësi. Atë që e kam në pronësi do ta kaloj, do ta transferoj pronën. Do ta lë objektin e investimit, nuk e cenoj atë që unë kam interes si shtet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Si ta bëjmë? Ai është ministri përgjegjës, prandaj e njeh Kushtetuta. Nuk ka rëndësi sesi e ka emrin, nëse e ka Fatmir, Vasilika, Petrit apo Bashkim. Nuk ka lidhje me këtë.

Neni 38. “Shfuqizimi i vënies në dispozicion”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pronën e ka të vetën. Kjo është logjika apo e kam gabim?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

“Kur pronësinë e strukturave”, po ia ke bërë pronë, ai mund ta shesë atë, por ti i ke thënë se nuk mund ta shesësh për sa kohë që duhet ta dijë se cili e merr. Nuk mund t’ia japësh një njeriu që nuk di të bëjë turizëm. Kjo është logjika që ka dashur të thotë. Sot e ka “Hollydai”, do ta marrë simotra e saj që është në treg “Sheratoni”, pra të mos jetë një anonim. Besoj se kjo është logjika e ligjit. Kurse shfuqizimin e ka lënë pak më larg që të mos jetë abuziv, sepse unë kam hedhur para, vlera monetare të caktuara dhe vjen një ditë që ndërrohet ministri. Përgjegjësia të jetë pak më e madhe. Në këtë rast e kanë lënë të mos mbajë përgjegjësi individuale, por të ketë përgjegjësi kolegjiale.

Neni 39.

Bashkim Fino – Këtu thuhet: “ Për investimet pranë brigjeve, pranë deteve apo liqeneve mund të vihet në dispozicion një hapësirë e plazhit në raport me kapacitetin e strukturës apo të ndërtuesit”. Çfarë do të thotë “t’i vihet në dispozicion”? T’i vihet në dispozicion rëra përpara apo pjesa e liqenit? Ne kemi thënë që 20 -30 metra gjithë bregdetit është pronë publike dhe pronë e bashkisë dhe nuk ka të drejtë asnjëri tjetër, edhe ata që kanë fshatra turistike, mund të vijnë të tjerë të bëjnë plazh te zona e rërës dhe kanë të drejtë të vijnë, sepse është publike e gjithë kjo. Çfarë do të thuash? Këtij investitori i thua, parcelizojë, sepse kjo pjesa është jotja dhe nuk ka të drejtë të futet asnjëri, kur ajo është pronë publike, është e të gjithëve dhe ka të drejtë kryetari i bashkisë apo cili është që do ta menaxhojë. Po u bë, atyre do t’ia japë, nuk do ta mbajë

për vete, ata do ta menaxhojnë, ata që kanë investimin, por ti kot e vë këtu. Kjo duhet të sqarohet më mirë, nuk mund të jetë kaq e thjeshtë.

Fatmir Xhafaj - Çfarë duhet të sqarohet? Edhe zoti Fino nuk është dakord që ta heqësh. Një njeri që ka bërë një resort turistik dhe i thua nuk ke dalje në det...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në të gjitha vendet ku kemi shkuar në resortet turistike, është i shkruar emri me të mëdha, që te kjo pjesë çadrat...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, nuk janë të rrethuara. Këtu nuk thotë të vihen të rrethuara, thotë hapësirë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ervin Mete - Për të sqaruar logjikën dhe pastaj formulimin është e domosdoshme që për strukturat turistike, këtu janë pasur parasysh struktura turistike si komplekse të një madhësie të caktuar, resorte, të vihet në dispozicion edhe një hapësirë e plazheve apo e bregut. Nga ana juridike ajo është gjithmonë pronë publike, siç thotë me të drejtë zoti Fino, por tagrin e administrimit të kësaj prone publike e ka Këshilli i Ministrave. Sot aplikohet me një VKM për pushtetin vendor për të dhënë qira përdorimi. Çfarë ka ndodhur? Ka pasur resorte që nuk kanë arritur ta marrin këtë dhe për shkak të një konflikti të tejzgjatur mund të jetë bllokuar edhe investimi. Këshilli i Ministrave apo ministri mund të shprehen për pjesë të caktuara të brigjeve që t'i kalojnë për një kohë të caktuar si pjesë funksionale ose në përdorim strukturës akomoduese, pra strukturës turistike.

Fatmir Xhafaj – Bëni një riformulim për këtë. Dakord?

Neni 40. “Zonat ku nuk ka përfunduar regjistrimi fillestar”. Jemi dakord.

Neni 41. “Investimi jashtë zonave me përparësi zhvillimin e turizmit”.

Bashkim Fino - Jam totalisht kundër. Pse jam kundër? “Lejet e ndërtimit për strukturat akomoduese jashtë zonave me përparësi zhvillimin e turizmit në rastet kur jepet nga autoriteti vendor i planifikimit, marrin pëlqimin paraprak të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit”. Pse duhet ta marrë pëlqimin paraprak? Në nenet më përpara thamë se do të kemi një planifikim të territorit me përparësi turizmin që të miratohet e të tjera me radhë. U miratua dhe do të quhet pjesë turizmi. Kjo pjesa tjetër nuk është zonë turistike. Unë, kryetari i bashkisë e jap, ti thua: hajde më kruaj mustaqet, pastaj ta japësh ti. Ky është turp.

Fatmir Xhafaj – Ti ia ke dhënë lejen që kur ke bërë planin dhe i ke thënë se kjo do të jetë shtëpi. Ai duhet të kalojë edhe nga ministria.

Ervin Mete - Respektoj pozicionin tuaj. Po marr një shembull “Sheratonin”, nuk është në zonë me përparësi zhvillimin e turizmit, por është një strukturë e rëndësishme turistike, e cila zbaton dhe duhet të zbatojë standarde të unifikuara. Për sa u përket standardeve, mundet që ministria si mbajtëse e kësaj njëtrajtësie, të japë një mendim.

Fatmir Xhafaj - E keni vënë te njësitë akomoduese që duhet të jenë kështu e ashtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Neni 42. “Strukturat akomoduese”.

Më falni, mos gabo, sepse nuk jam specialist i turizmit, dhomat me qira, futen si struktura akomoduese të turizmit familjar? Nuk është këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vasilika Hysi - Zoti Vasili, nëse kthehemi te “fjetje edhe me mëngjes”, thuhet se maksimumi kjo strukturë akomoduese ka 50 dhoma ose 100 krevate. Ne flasim për bizneset familjare që e përmendi zoti Fino, në fshatin Dardhë, në Voskopojë ...

Fatmir Xhafaj – Si e ka përkufizimin?

Vasilika Hysi – Këtu nuk e keni përkufizuar.

Ervin Mete – ky është përkufizim ndërkombëtar. Ti nuk i thua dot “turizëm familjar”. Ky është një koncept social më shumë.

Në pikëpamjet e standardit turistik kjo strukturë afron në maksimumin e vet vetëm “shtrat dhe mëngjes”.

Fatmir Xhafaj – Ka një gjë këtu: me përkufizimin që i kanë dhënë “fjetje dhe mëngjes”, e kanë bërë: “struktura akomoduese me një shërbim të intimiduar krevati dhe mëngjesi të ofruar për klientin”. Kjo strukturë akomoduese ka një maksimum prej 50 dhomash dhe 100 krevatesh, nuk ofron shërbime restoranti, por vetëm ofrim mëngjesi për klientët.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mund të bëni një përkufizim?

Dakord. Këtu ndryshoni përkufizimin.

Vazhdojmë me kriteret e ndërtimit të strukturave akomoduese. “Këshilli i ministrave me propozim të ministrisë miraton rregulloren përkatëse për kushtet dhe kriteret për projektimin e strukturave akomoduese”.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Vjen një ministër e thotë që vi unë atje e nuk marr vesh asgjë, ja siç bëra pyetje tani, por nuk jam njohës i fushës dhe mund të bëj ndonjë gabim. Kurse qeveria mban edhe një përgjegjësi politike për këtë gjë.

Dakord 43.

44. Klasifikimi i strukturave akomoduese, bujtinë, kamping, fjetinë e të tjera.

Pikën 5 me të drejtë kanë thënë që ta formulojmë kështu: “Këshilli i Ministrave bazuar në standardet ndërkombëtare miraton kushtet kriteret e të tjera”. Pra që t’i vëmë njëlloj detyrimi dhe kufiri dhe Këshillit të Ministrave.

A ka tjetër.

Vasilika Hysi – Te pika 5 thuhet “ Kushtet kriteret dhe afatet procedurat e klasifikimi i strukturave bëhet sipas rregullores me urdhër të ministrit”.

Fatmir Xhafaj – Unë them ta bëjë Këshilli i Ministrave.

Vasilika Hysi – Po. Ta bëjë Këshilli i Ministrave.

Fatmir Xhafaj - Neni 45.

Vasilika Hysi – Në rast se ne do të ndryshojmë nenin 5, do të shohim pak, më falni, edhe pikën 5 të nenit 44, duhet të shohim edhe pikën 6 ku thuhet: “Ministria përgjegjëse për turizmin bashkëpunon me agjencinë dhe organizatat e njohura për miratimin rregullores dhe klasifikimin e strukturave”. Pra, pika 5 thotë që rregulloren e harton ministria përgjegjëse për turizmin, ndërsa pika 6 është vijimi i pikës 5, që ju sapo e propozuat. Por te neni 44 na ka shpëtuar përputhshmëria harmonia midis pikës 5 dhe 6.

Fatmir Xhafaj – Jemi te 45-a.

Vasilika Hysi – Po, te neni 44 na ka shpëtuar përputhshmëria, harmonia midis pikës 5 dhe 6.

Fatmir Xhafaj – Po pra e vumë, Këshilli i Ministrave.

Vasilika Hysi – Po pika 6. Pika 6 është: Ministria përgjegjëse për turizmin bashkëpunon me agjencitë dhe organizma të mirënjohura ndërkombëtare për hartimin e rregullores dhe klasifikimin e strukturave akomoduese”.

Fatmir Xhafaj – Po, me propozim të ministrit, pra.

Po. 45 dakord.

Kemi në ligj një marrëdhënie midis pronarit të njësisë akomoduese me klientin. Detyrimet, përgjegjësitë kush i përcakton? Në cilin nen janë? Është si puna e atij pallatit që kam blerë unë e që as viti nuk i është mbushur dhe i ka dalë uji në parking dhe ai thotë që nuk pyes më, e ndërtova unë. Edhe ne bëmë INUK-un, por nuk bëmë atë që merrej me cilësinë e objekteve.

Megjithatë mbetet e hapur kjo. Dakord?

Po e gjetëm, po nuk e gjetëm duhet futur diçka në ligj.

Neni 46. Iva mbaje shënim të lutem.

Faleminderit!

Po neni 46. Agjencia e udhëtimit.

Vasilika Hysi - Te pika 1 thuhet që “shërbimet e agjencisë së udhëtimit përfshijnë, por nuk kufizohen me” kur thoni, “nuk kufizohen me” mund të marrin edhe detyra të tjera përveç gjithë kësaj liste?

Fatmir Xhafaj – Biznes privat janë ata.

Vasilika Hysi – Ai mund të ketë edhe biznese të tjera, por flasim për operatorët turistik.

(Ndërprerje incizimi).

Te neni 47. Licencimi dhe rregullat e ushtrimit të një veprimtarie. Pra, agjencia duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

Të jetë i regjistruar në QKR.

Përfaqësuesi ligjor të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për një vepër penale që përfshin mashtrim evazion fiskal praktika korruptive.

Po pedofil, po trafik armësh pse mos të jetë? Agjencitë turistike mund të bëjnë vepra penale shumë më të rënda se këto. Mund të jetë pastrim parash, trafik qeniesh njerëzore. Atëherë, të themi për një vepër penale dhe t’i heqim këto.

Petrit Vasili – E ke presje aty.

Vasilika Hysi – Zoti Vasili, kur thuhet vepër penale edhe mashtrimi është vepër penale, edhe evazioni fiskal. Vepra penale janë të gjitha këto. Po mos harroni se nuk janë vetëm këto vepra penale.

Petrit Vasili – Vepër penale presje, po në mënyrë të veçantë kam specifikuar edhe dytri gjëra. Nuk bën dëm i ka të gjitha.

Vasilika Hysi – Një person brenda një periudhe 5- vjeçare, një njeri që është marrë me trafikim fëmijësh qeniesh njerëzore, organesh i hiqet licenca përjetësisht, nuk mund t’ia heqësh licencën për 5 vjet. Prandaj do të doja, i kërkoj Ivës që germën “b” ta shikojë edhe me Koneventën e Palermos dhe dy protokollet shtesë, ku ka një sërë edhe me ligjin për përgjegjësinë penale të personave juridik.

Ka rregulla specifike për një kategori veprash penale, sepse 5 vjet është pak.

Nuk ka të drejtë të futet në tender, nuk ka të drejtë të ushtrojë veprimtari. Ka disa rregulla. Ta shikojmë pak këtë, ju lutem.

Fatmir Xhafaj – Që të ketë kushte specifike deri në moshën 45 vjeç.

Dakord me sugjerimet neni 49.

Neni 50.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Po edhe më e mirë është kjo për ju si ministri.

Bashkim Fino – Si thotë kryeministri, “Dal darkave dhe nuk gjej taksist që nuk ka mbaruar juridikun”. I bie që ai mund të ketë mbaruar juridikun që thotë kryeministri një nga taksistët dhe mund të jetë drejtues thotë. Nuk mund ta vëmë drejtues me edukim profesional.

Fatmir Xhafaj - Operatori turistik, po.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

E ka të shkruar. Thotë: “Përfaqësuesi ligjor administratori dhe drejtuesi teknik të zotërojë një diplomë të ciklit të parë në përputhje me objektin e veprimtarisë së biznesit”.

Nëse ai është hotel duhet të ketë mbaruar hoteleri.

Vasilika Hysi – Në vazhdim të sugjerimit që bëra për nenin 47 pika “b”, sugjeroj që të rishitet edhe pika “b” e nenit 50. Jo vetëm për tërësinë e veprave penale, por edhe për terminologjinë.

Fatmir Xhafaj – Dakord me sugjerimet dhe vërejtjet që u bënë.

Neni 54 garancitë e operatorëve turistikë.

Këtu janë garancitë e operatorit turistik. A mund të kemi ndonjë detyrim që t'u vëmë atyre të kenë një fond.

Dakord.

Po paratë e tyre janë

Po në arstet që janë këto operatorët që me këto probleme që na kanë ndodhur me shoqëritë turistike që nuk i çojnë pasagjerë? Kjo kështu duhet të jetë që i mbulojnë shoqëritë e sigurimit? Kam përshtypjen se nuk duhet të jetë kështu kjo.

Duhet të ketë diçka që t'i mbulojë, t'i dëmshpërblejë. Nuk e zgjidh. Kjo është rasti për dëmet e shkaktuara.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Shikojeni njëherë kush do t'i mbulojë detyrimet! Po që se kjo jua plotëson dakord jam unë.

Vasilika Hysi – Po i lëmë klientët.

Fatmir Xhafaj – Ka dalë një problem i madh për juve do të ishte lehtësim nëse do të kishit një fond që do të kishte mundësi ta menaxhonte pastaj ministria.

Garancia është për dëmet.

Dakord. Nëse kjo jua zgjidh jemi dakord. Po shikojeni njëherë.

Po ka nevojë për ndonjë saktësim shikojeni.

Neni 56 kriteret e për certifikimin e udhërrëfyesit turistik.

Një lloj kriteri për certifikatë duhet të ketë.

Neni 57 Dokumenti identifikues i një udhërrëfyesi turistik.

Neni 58. Rinovimi i certifikatës së udhërrëfyesit turistik.

Dakord.

Neni 59. Edukimi profesional në vazhdim.

Dakord.

Neni 60 . Udhërrëfyesi turistik i huaj.

Dakord.

Transporti turistik dhe sipërmarrjet e tjera turistike.

Neni 61. Udhërrëfyesi turistik i nderit.

Dakord.

Neni 62. Transporti turistik.

Duhet pak më e detajuar kjo pikë.

Dakord.

Neni 63 Kriteret e sigurisë për automjete kualifikimet nuk mund të përmenden të gjitha këto që të ketë udhëzime për t'i orientuar?

Neni 63 Stacionet e plazhit.

Dakord.

Neni 64. Parimet bazë. Parimet bazë , mbledhja e të dhënave statistikore bëhen në përputhje me parimet duhet shtuar edhe ligji për mbrojtjen e të dhënave personale?

Dakord.

Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave statistikore.

Neni 65 dakord. Te neni 64 e thashë parimet bazë.

Neni 67. Edukimi, ndoshta duhet të futet edhe shkollat e mirëfillta profesionale.

Dakord.

Neni 68.

Dakord.

Neni 69.

Dakord.

Po në ligj pse nuk ka nenin 70?

Nenin Rastet e kundërvajtjes administrative duhet ta shikojmë.

Ushtrimi i veprimtarisë së pa plotësuar kërkesat dhe kriteret sipas nenit 43 dënohet me gjobë 200 mijë lekë dhe ushtrimin e veprimtarisë pa licencën përkatëse. Njësoj janë këto të gjitha pa asnjë ndryshim.

Ai ka bërë kriteret në ndërtim dhe merr 2000 lekë ky i shkreti që e ka marrë shkollën një vit më pas apo nuk e ka në profesionin e caktuar ku merr 2 milionë lekë. Mbase duhet parë.

Neni 71. Ankimimi.

Vasilika Hysi – Unë kam një sugjerim. Te pika 2 ku thuhet: “ Procedura e konstatimit e vendosjes së ankimimit dhe ekzekutimit bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative”. Konstatim vendosje, ankimim dhe ekzekutim të gjobave.

Fatmir Xhafaj – Te neni 71 “Ankimimi” duhet futur Gjykata Administrative.

Dakord, zoti Mete?

Dakord.

Neni 72 Të ardhura nga vendosja e gjobave.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

100% e buxhetit të shtetit nuk i kalojnë atij fondit që keni për projekte, zoti Mete?

Neni 73. Dispozita kalimtare.

Dakord.

Neni 74. Aktet nënligjore.

Do të shikohet në fund.

Neni 75 Shfuqizimet.

Dakord.

Neni 76 Hyrja në fuqi .

Dakord.

Të reflektohet dhe të bëhet raporti me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet e bëra dhe ta votojmë në parim kur të jetë kuorumi i nevojshëm.

MBLEDHJA MBYLLET

